| 8 | 00 | 05 | 01110 | 230 | 2302000 | 1420145 | Hartim projekt - preventiva | 4,500 | 4,500 | 0 | 1,864 | 0 | 0 | 1,864 |
| 8 | 00 | 05 | 06260 | 231 | 2315140 | 1420146 | Blerje mjete transporti | 4,000 | 4,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | 00 | 05 | 01110 | 231 | 2313100 | 1420122 | Rikonstruksion rruge ne qytet + blloqe banimi | 4,856 | 1,500 | 3,356 | | 3,356 | 0 | 0 |
| | 00 | 05 | 04260 | 231 | 2313400 | 1420107 | Rikonstruksion lera e permiresim kullote | 0 | 0 | 0 | 14,892 | 4,734 | 5,158 | 5,000 |
| | 00 | 05 | 04260 | 230 | 2302000 | 1420138 | Hartim plane mbareshtimi pyje kullota | 0 | 0 | 0 | 9,996 | 3,996 | 3,000 | 3,000 |
| | 00 | 05 | 06260 | 231 | 2315140 | 1420146 | Blerje mjete transporti | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| INVESTIME GJITHSEJT | | | | | | | SHUMA II | 55,778 | 32,781 | 22,997 | 26,752 | 25,537 | 14,348 | 9,864 |
| | | | | | | | BUXHETI TOTAL ( I+II ) | 97,931 | 55,397 | 29,927 | 114,484 | 44,237 | 49,110 | 51,064 |

**DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK & MENAXHIMIT FINANCIAR**

Nr 563 prot Relacioni Dt. 24.03.26

# Relacioni

## Përgatitjes së parshikimeve afatmesme te te Ardhurave dhe tavaneve pergatitore te PBA 2027-2029

Te nderuarr Keshilltare !

Ne mbeshtetje te

- Neneve 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
- Nenit 35, të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
- Nenit 8, pika 8(b), dhe Nenit 27 të Ligji Nr. 10296/2010, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",
- Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"
- Udhëzimit Nr. _7_ datë 27.02.2026 ,të Ministrit të Financave "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029

Bazuar ne vleresimet dhe parashikimet afatmesme te perditesura te te ardhurave dhe tarnsfertave nga Buxheti i Shtetit po ju paraqesim per miratim programin buxhetor afatmesem 2027-2029 Ky raport i vleresimeve dhe parashikimeve afatmesme te te ardhurave dhe shpenzimieve permban te dhena per dy vitet para vititi buxhetor,vititi buxhetor dhe tre vitet e radhshme buxhetore,

Ne kete raport perfshihen
a ) metodologjia e perdor per parashikimen
b ) analiza e efekteve te politikave te reaj fiskale me ndryshimin te atyre ekzistuese dhe
c )analiza e risqeve dhe masave per perballimin e tyre

**Pasqyra Nr 1**

Parashikimet afatmesme te te Ardhurave 2027-2029

| Nr | Emertimi I te ardhurave | 2027 | 2028 | 2,029 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Te ardhura te trasheguara | 2,000 | 2,000 | 2,000 |
| 2 | Te ardhurat e veta | 67,000 | 68,000 | 70,000 |
| 3 | Transferta e pakushtezuar | 176,619 | 184,736 | 192,904 |
| 4 | Transferta sektoriale | 140,017 | 140,017 | 141,417 |
| | TOTALI I BUXHETIT | **385,636** | **394,753** | **406,321** |

***Listë e programeve të shpenzimeve që përdorin Bashkia Tepelenee dhe përshkrimet e tyre.***

| Nr. | Emri i Programit/Produktit | Përshkrimi i Produktit |
|---|---|---|
| **1** | **Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (01110)** | |
| | Shërbimi i Stafit të Administrim & Menaxhim | Këtu përfshihen shërbimet e dhëna nga Kryetari, Nënkryetarët, kabineti, sekretari i përgjithshëm, drejtuesit dhe specialistët e lidhur me funksionet mbështetëse të NJVQV si Burimet Njerëzore, Financa, IT, Juridike, Prokurime, Auditi, etj. (përfshirë QKR, QKB, NJA, kryepleqtë). Pagesa e Pagave dhe sigurime apo honorare për stafin. |
| | Akte te miratuara nga Këshilli Bashkiak | Shërbime të ofruara nga Këshilli Bashkiak dhe stafi i tij kundrej administratës dhe komunitetit. Pagesa e honorareve për anëtarët e KB dhe shpenzimeve të tjera për funksionimin e KB. |
| | Mirëmbajtja e Infrastrukturës dhe Funksionimi i Aparatit të Bashkisë | Funksionimi dhe mirembjatja e Infrastruktures fizike te bashkise përmes sigurimit të shpenzimeve korente apo kapitale për ujë, energji elektrike, internet, telefon, mirëmbajtje, kancelari, karburant dhe mirëmbajtje për mjetet e transportit, pajisje apo furnitura të tjera IT, etj. |
| | Përmbushja e Detyrimeve Gjyqësore | Ndjekja e cështjeve gjyqësore dhe shlyerja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore. |

| | | |
|---|---|---|
| | Nëpunës të trajnuar | Zhvillimi i burimeve njerëzore përmes trajnimeve apo programeve kualifikuese të zhvilluara nga vetë NJVQV apo palë të treta (p.sh. ASPA, projekte të ndryshme, etj.) Këtu do të përfshihen të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me trajnimet, si p.sh. materialet, qera ambjente trajnimi, pagesa për trajnuesit, shpenzime transporti, akomodimi, dieta, etj. |
| | Subjekte tregtare të Inspektuara | Këtu përfshihen të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e lidhura me Drejtorinë e të Ardhurave (apo Taksave Vendore), duke filluar nga kostot e personelit; shpenzime korente apo kapitale për funksionimin (utilitare, karburant, kancelari, etj.) apo mirëmbajtje (automjetesh apo infrastrukture tjetër fizike); shpenzimet për dieta, transport, etj.; shpenzime për promovime apo fushata sensibilizuese; shpenzimet për barrën siguruese dhe hipotekore, urdhra bllokimi, pagesa per RBS nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, etj. |
| | Transparenca publike | Shërbime dhe kostot përkatëse të printimit (ftesa, broshura,m baner, city light, kartolina, albume), prodhim spoti promovues, mbështetje për hostimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e ëebsite, promovimi i aktiviteteve në rrjetet sociale, etj. |
| **2** | **Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (03280)** | |
| | Shërbime të mbrojtjes civile | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e mbrojtjes civile. |
| | Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit | Ky produkt ka të bëjë me krijimin e gadishmërisë së duhur njerëzore, mjete dhe materiale për t'ju përgjigjur në kohë rasteve të zjarrit dhe shpëtimit në objekte banimi, pyje dhe kullota, aksidente në rrugë, etj. Këtu do të përfshihen njëkohësisht edhe aktivitetet dhe kostot përkatëse në lidhje me marrjen e masave parandaluese të zjarrit apo aksidenteve, përfshirë mjete apo materiale të nevojshme si dhe fushata të ndryshme sensibilizuese. |
| | Punonjës zjarrfikës të trajnuar | Zhvillimi i stafit në lidhje me proceset e trajtimit të rasteve të zjarrit dhe shpëtimit përmes trajnimeve apo programeve kualifikuese të zhvilluara nga vetë njësia apo palë të treta (p.sh. MB, projekte të ndryshme, etj.) Këtu do të përfshihen të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me trajnimet, si p.sh. materialet, qera ambjente trajnimi, pagesa për trajnuesit, shpenzime transporti, akomodimi, dieta, etj. |

| | | |
|---|---|---|
| | **Familje të dëmshpërblyera për dëme nga fatkeqësitë natyrore** | Shpenzimet e parashikuara në buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore për dëmshpërblimin e familjeve të cilat preken nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore. |
| | **Familje të dëmshpërblyera për dëme nga zjarri** | Shpenzimet nga buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore për shpërblimin e familjeve të dëmtuara nga zjarri sipas legjislacionit për mbrojtjen civile |
| **3** | **Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (04240)** | |
| | **Mirëmbajtja rutinë e kanaleve ujitëse dhe kanale kulluese** | Mirembajtja rutinë e XX Km lineare kanale ujitës dhe YY Km lineare kanale kulluese nëpërmjet pastrimit, sistemimeve, mirëmbajtjeve, meremetimeve apo zëvendësimit të torbinove, etj. Këtu përfshihen shpenzime e personelit për ofrimin rutinë të shërbimit të menaxhimit të ujitjes dhe kullimit si energji elektrike, kancelari, mjete dhe pajisje, materiale ndërtimi, etj. |
| **4** | **Administrimi i pyjeve dhe kullotave** | |
| | **Shërbimi i Stafit të menaxhimit të fondit Pyjor dhe Kullosor** | Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e monitorimit dhe mbrojtjes së tokës dhe pyjeve. |
| | **Inspektim dhe kontroll i sipërfaqes pyjore/kullosore** | Ky produkt përfshin aktivitetet e inspektimit të të gjitha hapësirave kullosore dhe pyjore për prerje të paligjshme të lëndës drusore duke marrë parasysh hapësirat e shfrytëzuara dhe ato të pashfrytëzueshme, si edhe kostove të nevojshme të lidhura me funksionimin e këtij shërbimi. |
| | **Sipërfaqe kullotë e pastruar në NJA** | Pastrimi dhe sistemimi i sipërfaqeve të kullotave për t'i bërë ato të gatshme për shfrytëzim. |
| | **Sipërfaqe kullotë e rehabilituar** | Investime dhe rehabilitime të sipërfaqeve të kullotave malore dhe fushore; pastrimi dhe sistemimi i baseneve të ujit; etj. |
| | **Siperfaqe pyjore e rehabilituar** | Ripyllëzimi i sipërfaqeve të djegura dhe sipërfaqeve të përdorura duke investuar në pyje me standartin 1667 fidanë/ha sipas skemës 3m x 2m; sistemime malore me gabiona dhe mure guri; etj. |
| **5** | **Rrjeti rrugor rural (04520)** | |
| | **Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes Rrjetit Rrugor Rural** | Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e Rrugëve Rurale |
| | **Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur** | Mirëmbajtje rutinë dhe periodike e XX Km infrastrukturës rrugore rurale. Monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës rrugore; Hartimi i planeve dhe i procedurave të prokurimit për ndërhyrje në mirëmbajtjen e rrugëve; sigurimi i |

| | | |
|---|---|---|
| | | mjeteve dhe bazës materiale për pastrim kanali, mbushjes së gropave me cakull, beton ose asfalt; etj. |
| | Rrjet Rrugor Rural i rehabilituar | Rehabilitimi i infrastrukturës rrugore rurale dhe lidhja e rrugëve dytësore me ato kryesore dhe nacionale. Monitorimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës rrugore; Hartimi i planeve, procedurave të prokurimit dhe zbatimi i ndërhyrjeve në rehabilitimin e rrugëve përmes zëvendësimit të shtresave të asfaltit, shtrimi i shtresave shtesë, pajisja e infrastrukturës rrugore rurale me sinjalistikë horizontale dhe vertikale, etj. |
| **6** | **Menaxhimi i mbetjeve (05100)** | |
| | Shërbimi i stafit të menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit | Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për sektorin e Pastrimit të qytetit, NJA; mbledhjen, transportimin dhe depozitimin e mbetjeve. |
| | Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane | Mbetje të ngurta të mbledhura dhe të transportuara nga zonat urbane drejt vend-depozitimeve në një vit. Këtu përfshihen aktivitetet dhe shpenzimet e blerjes së karburantit për drejtimin e operacioneve të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave një herë në ditë për një distancë mesatare prej XX km në ditë; blerjen, mirëmbajtjen dhe dizifektimin e kontenierëve të mbetjeve; mirëmbajtjen apo ripërtëritjen e mjeteve dhe pajisjeve të transportit apo grumbullimit; etj. |
| | Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve | Mbetje të ngurta nga zonat urbane dhe rurale të depozituara dhe trajtuara në landfield-e nga vetë bashkia apo nga një subjekt i kontraktuar (kundrejt tarifës së depozitimit). Këtu përfshihen të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet përkatëse të trajtimit të mbetjeve në vend-depozitim. |
| | Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale | Mbetje të ngurta të mbledhura dhe të transportuara nga zonat rurale drejt vend-depozitimeve në një vit. Këtu përfshihen aktivitetet dhe shpenzimet e blerjes së karburantit për drejtimin e operacioneve të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave dy herë në javë për një distancë mesatare prej YY km në ditë; blerjen, mirëmbajtjen dhe dizifektimin e kontenierëve të mbetjeve; mirëmbajtjen apo ripërtëritjen e mjeteve dhe pajisjeve të transportit apo grumbullimit; etj. |
| | Pastrimi i rrugëve dhe parqeve | Kjo është sipërfaqja e rrugëve urbane që fshihet/lahet çdo ditë gjatë gjithë vitit. Këtu përfshihen edhe shpenzimet për kriposjen e rrugëve apo pastrimin e tyre nga dëbora gjatë muajve të dimrit. |

| | | |
|---|---|---|
| | Subjekte të inspektuara | Ky produkt përfshin aktivitetet dhe kostot që lidhen me inspektimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të subjekteve apo aktiviteteve me qëllim mbrojtjen e mjedisit. Këtu do të përfshihen si shpenzimet e personelit, ashtu edhe ato të operimit të shërbimit. |
| | Promovimi i mbrojtjes së mjedisit | Realizimi I aktiviteteve të ndryshme për sensibilizimin apo impakt të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit. |
| 7 | **Sherbimet Publike Vendore (06260)** | |
| | Shërbimi i stafit të ndërmarrjeve publike të gjelbërimit, varrezave | Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve shoqërore për sektorët e mirëmbajtjes, gjelbërimit, menaxhimit të varrezave, dekorit të qytetit. |
| | Mirëmbajtja e sipërfaqes së varrezave | Siperfaqe ekzistuese e varrezave të qytetit të mirëmbajtura. Mirembajtja dhe sistemimi i parcelave të varrezave, rrugëve dhe trotuarëve ndarës; prokurimi i fidanëve; sistemimi i zonave te gjelberta; etj. |
| | Rruge urbane e mirëmbajtur dhe rehabilituar | Rruge urbane e mirembajtur ne qytetet e NJVQV duke bërë kontrolle dhe ndërhyrje periodike për mbushjen e gropave, rregullimin e sinjalistikës; etj. |
| | Sipërfaqe e gjelbër e mirëmbajtur dhe rehabilituar | Mbjellje, shërbim, dhe mirëmbajtja e pemëve dekorative dhe shkurre me gjelbërim të përhershëm, shërbim bari i kultivuar, natyral, tapet bari, uje, punim rrënjësh, pleherim, spërkatje me pesticide. Kryerja e kontrolleve të rregullta të mirëmbajtjes për dy makineri (2 prerëse bari) |
| | Trotuare të mirëmbajtur dhe rehabilituar | Sipërfaqe trotuaresh e mirëmbajtur në qytetet e NJVQV duke bërë kontrolle dhe ndërhyrje periodike për mbushjen e gropave, zëvendësimi i pllakave dhe bordurave, rregullimin e sinjalistikës; rregullimin e stolave; etj. |
| | Objekte publike të mirëmbajtura | Mirëmbajtja rutinë dhe periodike e objekteve të ndryshme administrative në pronësi të bashkisë, si psh. lapidare, shatërvane, etj. |
| | Shërbimi i stafit të mirëmbajtjes së Ndricimit Publik | Shërbimi dhe pagesa e pagave dhe sigurimeve për stafin që merret me Ndricimin Publik |
| | Rrjeti i ndricimit rrugor publik urban i mirëmbajtur | Rrjeti aktual i ndriçimit i mirëmbajtur dhe funksional në zonat qytet të NJVQV; blerja e furnizimit me energji; prokurimi i 1000 llambave të ndriçimit LED për zëvendësimin e llambave me ndricim të ngrohtë, 55 shtyllave të ndriçimit, 10 km kabllo elektrik; etj. |

| | | |
|---|---|---|
| | Rrjeti i ndricimit rrugor publik rural i mirëmbajtur | Rrjeti aktual i ndriçimit i mirëmbajtur dhe funksional në zonat rurale të NJVQV; blerja e furnizimit me energji; prokurimi i 100 llambave të ndriçimit, 5 shtyllave të ndriçimit, 1 km kabllo elektrik; etj. |
| **8** | **Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat (08220)** | |
| | Shërbimet e stafit të trashëgimisë Kulturore, muzeve, bibliotekave | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në stafin që mbulon objektet e trashëgimisë kulturore, muzetë dhe bibliotekat e njësive të vetëqeversijes vendore. |
| | Objekte të trashëgimisë kulturore të mirëmbajtura | Njësitë e vetëqeverisjes vendore do të përfshijnë në këtë produkt shpenzimet që lidhen me mirëmbajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore brenda territorit të tyre. |
| | Promovimi i trashëgimisë kulturore | Shpenzimet për broshura, për pika informimi, shfaqje kulturore dhe artistike për promovimin e trashëgimisë kulturore apo forma te tjera për promovimin e trashigimisë kulturore brenda territorit të njësive te vetëqeverisjes vendore. |
| | Funksionimi i Bibliotekës | Shpenzimet për mirëmbajtjen, funksionimin dhe shtimin e fondit të librave për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ofrojnë biliotekat në territorin e njësive të vetëqeverisjes vendore. |
| | Shërbimet e stafit të Artit dhe Kulturës | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në stafin që merret me aktivitetet artistike dhe kulturore të njësive të vetëqeverisjes vendore. |
| | Objekte të veprimtarisë kulturore dhe artistike të mirëmbajtura dhe funksionale | Njësitë e vetëqeverisjes vendore planfikojnë shpenzime në këtë produkt për mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionimit të plotë të objekteve të veprimtarisë kulturore dhe artistike. |
| | Shfaqje teatri | Në këto shpenzime përfshihen shpenzimet për materialet e nevojshme të shfaqjeve të teatrit (kostume, skena, etj.), dieta, honorare apo transporti për realizimin e shfaqjeve jashtë territorit të NJVQV, etj. Këtu do të përfshihen gjithashtu shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore për të mbuluar kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimit të teatrit publik në pronësi bashkise. |
| | Shfaqje kinemaje | Shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore për të mbuluar kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimit të kinemave publike në pronësi bashkise. Në këto shpenzime përfshihen shpenzimet për |

| | | |
|---|---|---|
| | | materialet e nevojshme të funksionimit të kinemave të bashkisë, fondi për blerjen/marrjen me qera të filmave, etj. |
| **9** | **Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë (09120)** | |
| | Shërbime mbështetëse të stafit të Arsimit Bazë | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në shërbimet mbështetëse të arsimit bazë, përfshirë atë parashkollor. |
| | Objekte te arsimit baze dhe parashkollor të mirëmbajtura dhe funksionale | Shpenzimet në buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore të planifikuara për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes dhe funksionimit të objekteve të arsimit bazë. Mirëmbajtja ka të bëjë me atë elektrike, hidrosanitare, klasat, dyer, dritare, lyerjet, etj. Këtu do të përfshihen gjithashtu edhe shpenzimet e funksionimit dhe ruajtjes (ujë, energji elektrike, ngrohje, dizifektim, sanitare, internet, kamerat e sigurisë, kancelari për sekretaritë, etj.) |
| | Fëmijë që ndjekin kopshtin | Shpenzimet që planifikojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për materiale te ndryshme didaktike që i shërbejnë fëmijëve të kopshteve. Këtu përfshihen shpenzimet për funksionimin e kopështeve (ujë, energji elektrike, ngrohje, shpenzimet e sigurisë), shpenzimet e mirëmbajtjes, kuzhinat e trajtimin ushqimor të fëmijëve, etj. |
| | Edukatorë të kualifikuar/trajnuar | Shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore për të mbuluar trajnimin apo kualifikimin e edukatorëve me qëllim rritjen e kapaciteteve. Në këtë produkt përfshihen të gjitha kostot për çdo edukator të trajnuar (shpenzime kursi trajnimi, dieta, transport, etj.) |
| | Fëmijë që frekuentojnë qendrat kulturore të fëmijëve | Shpenzimet për funksionimin e qendrave kulturore të fëmijëve në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin (materiale për kurset, ujë, energji elektrike, ngrohje, etj.) e këtyre qendrave, pagesat për ekspertët e jashtëm, zhvillimin e kurseve të ndryshme të baletit, kitarës, pikturës, etj. |
| | Objekte të arsimit bazë dhe parashkollor të rikonstruktuara | Shpenzimet që planifikojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për rikonstruksionin e objekteve të arsimit parashkollor si pasojë e amortizimit. |
| **10** | **Arsimi i mesëm i përgjithshëm(09230)** | |
| | Sherbime Mbeshtesese të stafit të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në shërbimet mbështetëse të arsimit të mesëm të përgjithshëm. |

| | | |
|---|---|---|
| | **Objekte te arsimit të mesëm të mirëmbajtura dhe funksionale** | Shpenzimet në buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore të planifikuara për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes dhe funksionimit të objekteve të arsimit të mesëm të përgjithshëm. Mirëmbajtja ka të bëjë me atë elektrike, hidrosanitare, klasat, dyer, dritare, lyerjet, etj. Këtu do të përfshihen gjithashtu edhe shpenzimet e funksionimit dhe ruajtjes (ujë, energji elektrike, ngrohje, dizifektim, sanitare, internet, kamerat e sigurisë, kancelari për sekretaritë, etj.) |
| | **Nxënës të akomoduar në konvikt** | Shepnzimet që planifikojnë njësitë e njevetëqeverisjes vendore për konviketet e arsimit të mesëm duke ju referuar numrit të nxënësve në këto objekte. Këto shpenzime përfshin rinovimin e paisjeve, rregullimet e brendshme, shpenzimet utilitare, të sigurisë, mencat dhe ushqimin për fëmijët konviktorë, etj. Përfshirë këtu shpenzimet për nxënësit e komuniteti rom të akomoduar në konvikte. |
| | **Nxënës të trajtuar me bursë** | Shpenzimet për trajtimin e nxënësve të arsimit të mesëm të përgjithshëm me bursë sipas kritereve të përcaktuara. Shpenzimet do të lidhen më numrin e nxënësve që do të jenë përfitues |
| | **Konvikte të rikonstruktuara** | Shpenzimet e planifikuara per rikonstruksionin e konvikteve të arsimit të mesëm të përgjithshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. |
| **11** | **Përkujdesja Sociale (10430)** | |
| | **Shërbimi i stafit të Kujdesit për Fëmijët dhe Familjet** | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në kujdesin social të familjeve dhe fëmijëve në nevojë. |
| | **Fëmijë që përfitojnë nga shërbimi social** | Shpenzimet buxhetore për mbulimin e fëmijëve që përfitojnë shërbimet të caktuara nga qendrat e shërbimit social apo shtëpitë e foshnjës në administrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore. Referuar numrit të fëmijëve që përfitojnë shërbim pranë këtyre funksioneve do të përllogariten shpenzimet e planifikuara për realizimin e këtij produkti. |
| | **Fëmijë që frekuentojnë cerdhet** | Shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore që lidhen me fëmijët të cilët frekuentojnë çerdhet publike në admisnitrimin e tyre. Kosto e këtij produkti do të jetë sa vlera e parashikuar e mbështetjes buxhetore për veprimtarinë operacionale, furnizimin me ujë, energji elektrike, ngrohje, shërbimet e sigurisë, trajtimi ushqimor, etj. |

| | | |
|---|---|---|
| | Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE | Shpenzimet që planifikojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore në buxhetin e tyre për mbështetjen e familjeve dhe individëve në nevojë që përfitojnë nga skemat e Ndihmës Ekonomike. |
| | Objekte të shërbimit të kujdesit social për familje dhe fëmijë të mirëmbajtura | Të gjitha shpenzimet që lidhen me mirëmbajtjen e godinave të njësive të vetëqeverisjes vendore të cilat janë në funksion të kujdesit social social për familje dhe fëmijë. |
| | Shërbimi i Stafit të Kujdesit Social | Ky produkt do të përfshijë aktivitetet dhe kostot përkatëse (paga, sigurime, etj.) të personelit të angazhuar në fushën e kujdesit social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara nën adminisimin e njësive të vetëqeverisjes vendore. |
| | Persona që përfitojnë kujdesin social | Shpenzimet që lidhen me qendrat ditore të kudjesit social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara. Të gjitha shpenzimet e mirëmbatjtes dhe kostot e tjera të funskionimit të këtyre qendrave përfshihen në këtë produkt. Përfshirë këtu treguesit e grave, të moshuarve dhe femijëve të asistuar me shërbim social. |
| | Individë AK që përfitojnë trajtim | Fondi e veta në dispozicion të njësive të vetëqeverisjes vendore për të mbështetur shërbimet ndaj individëve me aftësi të kufizuara. Shpenzimet lidhen me numrin e individëve që përfitojnë trajtim me fondin mbi aftësitë e kufizuara. |

**METODOLOGJIA E BUXHETIMIT NË BAZË PROGRAMI DHE PERFORMANCE PËR HARTIMIN E PBA** Buxhetimi mbi bazë Programi dhe Performance

Buxhetimi mbi bazë Programi dhe Performance (BPP) tregon lidhjet midis burimeve publike (inputeve), produkteve dhe rezultateve të arritura .

Modeli bazë i BPP-së (modeli BURIME – PRODUKTE – REZULTATE) Për qëllime të planifikimit (strategjik), për çdo funksion te Bashkise zhvillohet një program buxhetor për të cilin duhet të identifikohet qartë i gjithë zinxhiri, nga burimet e përdorua deri tek rezultati e arritura, për të siguruar një shkallë të lartë efiçence dhe efektiviteti të ndërhyrjes së Bashkise dhe për të siguruar rezultatin më të mirë të mundshëm për objektivin e synuar kundrejt përdorimit sa më të ulët të mundshëm të burimeve (input-eve).Gjithashtu, për qëllime monitorimi dhe vlerësimi, do të analizohet i gjithë zinxhiri për të shqyrtuar burimet e përdorura për arritjen e objektivave të programit deri tek produktet dhe rezultatet e arritura.

REZULTATET (Objektivat e përmbushuara)

INPUTET (burimet e caktuara)

AKTIVITETET (masat e marra)

PRODUKTET (shërbimet e ofruara)

Rëndësia Efektiviteti Ekonomia Efikasiteti

Përkufizimi i elementëve kryesorë të modelit bazë të BPP-së (ELEMENTI SHPJEGIMI)
Burime (Inpute) Inputet janë burimet në dispozicion të Bashkise për të ndërmarrë aktivitete dhe për të zbatuar politika të ndryshme. Inputet mund të jenë pasuri fizike, si ndërtesa, pajisje, kontribute njerëzore, si dhe kontribute financiare (siç janë financimi i programit nga qeveria) për të financuar pagat, investimet dhe transfertat e nevojshme për politikën në fjalë.

Aktiviteti Aktiviteti mund të përkufizohet si instrument i bashkise për të arritur një produkt të caktuar.

Rezultatet Rezultatet janë efekti pozitiv ose negativ i produkteve mbi përfituesit e synuar. Rezultatet janë të natyrës së menjëhershme ose afatshkurtër. Rezultatet matem me tregues kyç të performancës

Impakti Impakti nënkupton rezultatin afatmesëm ose afatgjatë të një politike publike në shoqëri. Impaktet formulohen si ndryshime që shkaktohen mbi gjendjen e përgjithshme të mirëqenies në shoqëri, gjë të cilën aspirojnë të arrijnë qeveritë. Impakti matet me tregues kyç të performancës..

Efiçenca Efiçenca formulohet si marrëdhënia ndërmjet produkteve dhe inputeve.

Efektiviteti Efektiviteti është marrëdhënia midis rezultateve dhe produkteve

GMS i Bashkise mbeshtetur ne transferten e pakushtezuar dhe transfertave sektoriale te derguar nga Ministrai e Financave , parashikim e te ardhurave ne periudhen afatmesem ,niveli i realizimit te buxhetit ne periudhat paraaardhese , mbajtjen e sherbimeve publike ne nivle optimal si dhe permbushja e te gjithe detyrimeve qe rrjedhin nga veprimtaria normale e Bashkise kemi te parashikuar te ardhurat e shpenzimet (tavanet pergatitore ) te programit Buxhetor afatmesem 2027-2029 ne nivel programi

**TAVANET PERGATITORE TE PBA 2027-2029**

**000/leke**

**Tavanet pergatitore sipas programeve buxhetore per periudhen afatmesme 2027-2029**

| Nr | EMERTIMI I PPROGRAMIT | Programi Buxhetor | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi | **O1110** | 111,093 | 115,750 | 126,538 |
| 2 | Fond Rezerve | **O4910** | 5,500 | 5,000 | 5,500 |
| 3 | Fond Kontigjence | **O4940** | 5,500 | 5,000 | 5,500 |
| 4 | Kujdesi social për femijet ( Çerdhe ) | **10140** | 8,068 | 8,270 | 8,525 |
| 5 | Sherbime publike vendore | **O6260** | 38,923 | 39,906 | 41,384 |
| 6 | Menaxhimi I mbetjeve | **O5100** | 33,822 | 36,042 | 36,888 |
| 7 | Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore | **O8220** | 12,055 | 12,356 | 12,850 |
| 8 | Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor | **O9120** | 74,772 | 74,772 | 68,922 |
| 9 | Arsimi i mesëm i përgjithshëm | **O9230** | 13,546 | 13,546 | 13,682 |
| 10 | Administrimi i pyjeve dhe kullotave | **O4260** | 17,315 | 17,344 | 17,422 |
| 11 | Menaxhimi i Infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit | **O4240** | 4,871 | 4,871 | 4,908 |
| 12 | Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile | **O3280** | 22,685 | 22,685 | 22,912 |
| 13 | Rrjeti rrugor rural | **O4520** | 22,486 | 23,910 | 25,790 |
| 14 | Mbrojtja civile | **O3280** | 15,000 | 15,300 | 15,500 |
| | **SHUMA** | | **385,636** | **394,753** | **406,321** |

**Pesha specifike per seicilin program kundrej buxhetit total.**

| Nr | EMERTIMI I PPROGRAMIT | Programi | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi | **O1110** | 29 | 29 | 31.6 |
| 2 | Fond Rezerve | O4910 | 1 | 1 | 1.3 |
| 3 | Fond Kontigjence | O4940 | 1 | 1 | 1.3 |
| 4 | Kujdesi social për femijet ( Çerdhe ) | **10140** | 2 | 2 | 2 |
| 5 | Sherbime publike vendore | O6260 | 10 | 10 | 10 |
| 6 | Menaxhimi I mbetjeve | **O5100** | 9 | 9 | 9 |
| 7 | Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore | **O8220** | 3 | 3 | 3.1 |
| 8 | Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor | **O9120** | 19 | 19 | 17 |
| 9 | Arsimi i mesëm i përgjithshëm | **O9230** | 4 | 3 | 3.3 |
| 10 | Administrimi i pyjeve dhe kullotave | **O4260** | 4 | 4 | 4.3 |
| 11 | Menaxhimi i Infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit | **O4240** | 1 | 1 | 1.2 |
| 12 | Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile | **O3280** | 6 | 6 | 5.6 |
| 13 | Rrjeti rrugor rural | O4520 | 6 | 6 | 6.3 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 14 | Mbrojtja civile | O3280 | 4 | 4 | 4 |
| | SHUMA | | **100** | **100** | 100 |

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik per periudhen afatmesme 2027-2029

| Nr | Emertimi I shpenzimit | Llog ekon | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pagat | 600 | 206,329 | 209,083 | 215,342 |
| 2 | Sigurime shoqerore | 601 | 33,472 | 33,920 | 34,950 |
| 3 | Shpenzime operative | 602 | 64,598 | 66,066 | 66,739 |
| 4 | Transferta te Brendeshme | 604 | 6,000 | 6,150 | 6,396 |
| 5 | Transferta te Individ | 606 | 5,000 | 5,125 | 5,330 |
| 6 | Fondi rezereve | 609 | 5,500 | 5,000 | 5,500 |
| 7 | Fondi kontigjences | 609 | 5,500 | 5,000 | 5,500 |
| 8 | Shpenzime kapitale | 230 | 5,471 | 5,600 | 5,700 |
| 9 | Shpenzime kapitale | 231 | 38,766 | 43,510 | 45,364 |
| 10 | Mbrojtja civile | 609 | 15,000 | 15,300 | 15,500 |
| | **BUXHETI** | | **385,636** | **394,753** | **406,321** |

Pesha specifike qe ze cdo shpenzim kundrejt tavane buxhetore te programuara.

| Nr | Emertimi I shpenzimit | Llog ekon | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pagat | 600 | 54 | 54 | 53 |
| 2 | Sigurime shoqerore | 601 | 9 | 8 | 8.6 |
| 3 | Shpenzime operative | 602 | 18 | 18 | 16.4 |
| 4 | Transferta te Brendeshme | 604 | 2 | 2 | 1.6 |
| 5 | Transferta te Individ | 606 | 1 | 1 | 1.3 |
| 6 | Fondi rezereve | 609 | 1 | 1 | 1.3 |
| 7 | Fondi kontigjences | 609 | 1 | 1 | 1.3 |
| 8 | Shpenzime kapitale | 231 | 10 | 11 | 12.5 |
| 9 | Mbrojtja civile | 609 | 4 | 4 | 4 |
| | **BUXHETI** | | **100** | **100** | **100** |

*Disa nga sfidat krysore të zhvillimit jane .*

•Zhvillimi i qëndrueshem ekonomik dhe finaciar

•Konsolidimi fiskal e financiar

•Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike dhe shtrirja e tyre në të gjithë territorin e Bashkisë

•Zhvillimi cilësor e mbështetja e bujqësisë

•Rritja e peshës së shpenzimeve kapitale në raport me të gjithë shpenzimet.

•Mbështetja e zhvillimit të turizmit mbetet një nga prioritet kryesore

•Rritja e transparencës ndaj komunitetit, bashkëpunimi dhe aktivizimi i tij deri në shkallën më të lartë të vendimmarrjes së përbashkët.

•Krijimi i kushteve për të thithur investime bazuar në studime dhe projekte konkrete për përmirësimin e infrastrukturës, për të plotësuar kështu nevojat e biznesit, industrisë dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës.

•Krijimi i kushteve të domosdoshme për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit arsimor, kulturor, sportiv dhe shëndetësor.

•Cilësi e lartë e jetesës dhe zhvillimin urban

Ju faleminderit !

DREJTORI (N/Zbatues )

Spiro Kora

KRYETARI BASHKISE

Gramos Sako

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA TEPELENE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr ..564/1...Prot

Tepelenë më, 21.3.2026

**PROJEKT V E N D I M**

Nr............, datë ..........2026

**"PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PA KUNDËRSHPËRBLIM NË FAVOR TË QENDRËS "ACEG", NJË PJESË TË OBJEKTIT PUBLIK SHKOLLA 9-VJEÇARE "ASIM ZENELI, FSHATI PROGONAT BASHKIA TEPELENE , DHE MIRATIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT QË DO TË NËNSHKRUHET PËR KËTË QËLLIM"**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pikat 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nënpika 1.6, shkronja "b", nenit 54, shkronjat "e/1", "f" dhe "k", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenet 901-912, të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, Ligjin nr. 8788/2001 "Për organizatat jofitimprurëse", Udhëzimin nr. 21, datë 23.08.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për përdorimin e ambienteve të institucioneve arsimore parauniversitare jashtë orarit mësimor.

si edhe në vijim të relacionit të grupit të punës nr. 180/ prot., datë 18.03.2026, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Dhënien në përdorim pa kundërshpërblim në favor të Qendrës "ACEG", një pjesë të pasurisë me numër 682 dhe siperfaqe ndërtimore 507 m2 të objketit shkolla 9-vjeçare "A.Zeneli" , përkatësisht kati i dytë.
2. Miratim të marrëveshjes së bashkëpunimit që do të nënshkruhet për këtë qëllim, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij për nënshkrimin e marrëveshjes së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Bashkia Tepelenë të ndjek procedurën sipas parashikimeve të këtij vendimi, si dhe nxjerrjen e çdo akti të nevojshëm për zbatimin e tij.

5. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e ligjore dhe shërbimeve Organizative, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit Sportit dhe Kujdesit Shoqëror, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**Arben Gumeni**

**DRAFT**

**I MARRËVESHJES DHE DHËNIES NË PËRDORIM TË NJË PJESE TË OBJEKTIT PUBLIK "SHKOLLA 9-VJEÇARE ASIM ZENELI" NË FSHATIN PROGONAT, BASHKIA TEPELENË, PËR ORGANIZIMIN E KAMPIT VEROR NGA QENDRA ACEG".**

**Bashkia Tepelenë**, përfaqësuar nga **Kryetari i Bashkisë**, Z: Gramos Sako, me adresë, sheshi '' Lord Bajron", Tepelenë (në vijim "Dhënësi i pronës").

**Qendra Albanian Center for Environmental Governance (ACEG)**, person juridik jofitimprurës me NIPT L62011451I, me adresë Rruga "Qemal Stafa", Tiranë, përfaqësuar nga **Drejtorja Ekzekutive** Znj. Margarita Buxhaku (në vijim "Përdoruesi").

**KUSHTE PARAPRAKE:**

4.1 Bashkia ka në pronësi pasurinë, me numër 682 dhe siperfaqe ndërtimi 507 m2, e ndodhur në zonën kadastrale 3057, me sipërfaqe trualli 5000 $m^2$, kaluar në pronësinë e Bashkisë Tepelenë ish Komuna Kurvelesh me vendimin nr. 386, datë 25.05.2011, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave tëpaluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronesi ose në përdorim të komunës Kurvelesh të Qarkut Gjirokastër" (Trualli dhe Objekti, sipas Aneks A, referohen në vijim bashkërisht si "**Pasuria**"), me qëllim realizimin e Projektit.

**Neni 1**
**Baza ligjore**

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1.2, shkronja "a" dhe nenin 64, shkronja "a" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; nenet 901-912 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; vendimit nr. 142, datë 23.12.2022, të Këshillit Bashkiak, të ndryshuar, dhe akteve të themelimit të kësaj organizate jofitimprurëse.

Për sa më sipër, Palët bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje bashkëpunimi për përdorimin e pasurisë Palët, pasi morën në konsideratë:

- Dokumentacionin e paraqitur me ''Këkesë" nga shoqata ACEG, pranë Bashkisë Tepelenë.
- Ligjet dhe aktet nënligjore të referuara në Projekt – Vendim.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak Tepelenë nr._____ prot, datë ____.____2026, "Për dhënien në përdorim të një pjese të objektit publik "shkolla 9-vjeçare ''Asim Zeneli" në fshatin Progonat, Bashkia Tepelenë, për organizimin e kampit veror nga qendra ''ACEG".
- Studimin e fizibilitetit për kampin veror "Foleja e Maleve", si dhe Ligjet dhe aktet nënligjore të sipërpërmendura,
- Udhëzimin nr. 21, datë 23.08.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për përdorimin e ambienteve të institucioneve arsimore parauniversitare jashtë orarit mësimor.
- Palët konstatojnë se projekti "Kampi Foleja e Maleve" ka karakter edukativ, social dhe mjedisor dhe realizohet pa qëllim fitimi, në përputhje me statutin e organizatës ACEG.

**RANË DAKORD PËR SA MË POSHTË:**

**Neni 1**
**Baza ligjore**

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1.2, shkronja "a" dhe nenin 64, shkronja "a" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; nenet 901-912 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; vendimit nr. 142, datë 23.12.2022, të Këshillit Bashkiak, të ndryshuar, dhe akteve të themelimit të kësaj organizate jofitimprurëse.

**Neni 2**
**Objekti i marrëveshjes**

Dhënësi i pronës i jep përdoruesit në përdorim, një pjesë të objektit "Shkolla 9-vjeçare Asim Zeneli" dhe oborrin e saj në fshatin Progonat, për realizimin e projektit edukativ dhe social "Kampi Foleja e Maleve", i cili synon zhvillimin e aktiviteteve edukative, sportive, kulturore dhe mjedisore për fëmijë dhe të rinj.

Veprimtaria zhvillohet pa qëllim fitimi, në përputhje me statutin e organizatës ACEG dhe në interes të komunitetit lokal.

Objekti përbëhet nga ndërtesa kryesore (sipërfaqe ndërtimi _ ***$m^2$) dhe trualli i përcaktuar*** (_ $m^2$) sipas planvendosjes në Aneks A të Relacionit Teknik.

**Neni 3**
**Afati i Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas miratimit në Këshill Bashkiak dhe nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vlefshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së qendrës.

Afati i përdorimit është 9 vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje huapërdorje, me të drejtë rinovimi me marrëveshje të palëve dhe miratim të Këshillit Bashkiak.

Në çdo rast, marrëveshja e nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë, mund të përfundojë para afatit me marrëveshje të palëve ose me vendim të njëanshëm të Dhënësit të pronës, në rast shkeljeje të kushteve nga Përdoruesi.

Kontrata që do të jetë burim i kësaj marrëveshje të miratuar nga Këshilli Bashkiak Tepelenë.

**Neni 4**
**Qëllimi i përdorimit**

Përdoruesi e merr objektin në përdorim për zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe sociale për fëmijë dhe të rinj, në kuadër të projektit "Kampi Foleja e Maleve".

Aktivitetet përfshijnë:

- edukim mjedisor dhe njohjen e natyrës
- aktivitete sportive dhe rekreative
- aktivitete artistike dhe kulturore
- njohjen e traditave dhe jetës rurale të zonës së Kurveleshit.

Përdorimi i objektit kufizohet në ambientet e papërdorura të shkollës dhe nuk cenon zhvillimin e procesit mësimor.
Përdoruesi nuk mund ta ndryshojë destinacionin e objektit, nuk mund ta nën-përdorë ose japë në nënqira objektin pa miratimin me shkrim të Dhënësit të pronës.

**Neni 5**
**Interesi publik dhe përfitimi për Bashkinë**

Realizimi i këtij projekti synon:
- rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të papërdorura të objektit publik
- zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe sociale për të rinjtë
- promovimin e zonës së Kurveleshit si destinacion i turizmit të natyrës
- përfshirjen e komunitetit lokal në aktivitete ekonomike dhe sociale
- krijimin e mundësive të punësimit sezonal për banorët e zonës.

Projekti kontribuon në gjallërimin social dhe ekonomik të zonës dhe në përdorimin më efikas të pasurive publike të Bashkisë Tepelenë.

**Neni 6**
**Detyrimet e palëve**

**Detyrimet e Përdoruesit:**

- Të marrë përsipër të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen, pastrimin, energjinë elektrike, ujin dhe kanalizimet, si dhe menaxhimin e mbetjeve gjatë periudhës së përdorimit.

- Të realizojë me shpenzimet e veta investimet e nevojshme për rikonstruksion, përshtatje të hapësirave, instalime elektrike, hidrosanitare e kanalizime, me miratim paraprak të Bashkisë dhe respektim të legjislacionit të ndërtimit.
- Të sigurojë pajisjet dhe shërbimet për sigurinë e kampit (sistem zjarrfikës, plan evakuimi, sigurim shëndetësor për pjesëmarrësit).
- Të raportojë çdo vit pranë Bashkisë mbi veprimtaritë e zhvilluara, numrin e pjesëmarrësve, investimet e kryera dhe impaktin socio-ekonomik.
- Të ruajë e mbrojë objektin, duke mos dëmtuar strukturën, fasadat, sistemet ekzistuese dhe mjedisin përreth.
- Të respektojë të gjitha standardet e sigurisë dhe higjienës për aktivitetet me fëmijë dhe të rinj.
- Të sigurojë praninë e stafit përgjegjës dhe të trajnuar gjatë zhvillimit të aktiviteteve.

**Detyrimet e Dhënësit të pronës:**

- Të dorëzojë objektin në gjendjen aktuale, sipas procesverbalit të dorëzimit.
- Të mbështesë Përdoruesin për marrjen e lejeve për investime dhe të koordinojë me institucionet përkatëse.
- Të monitorojë respektimin e kushteve të kontratës dhe të marrë masa në rast shkeljeje.

**Neni 7**
**Investimet dhe pronësia**

Çdo investim i kryer nga Përdoruesi në objekt mbetet pronë e Bashkisë Tepelenë pas përfundimit të afatit të përdorimit, pa të drejtë kompensimi.

Investimet e realizuara do të jenë ndërhyrje rehabilituese të lehta dhe nuk do të ndryshojnë strukturën ose destinacionin e objektit pa miratim të Bashkisë.

Nëse investimet rrisin ndjeshëm vlerën e objektit, palët mund të parashikojnë zgjatje të afatit të përdorimit, me miratim të Këshillit Bashkiak.

**Neni 8**
**Përgjegjësia dhe sigurimet**

Përdoruesi mban përgjegjësi të plotë për çdo incident, dëmtim ose humbje të shkaktuar gjatë përdorimit të objektit nga personeli ose pjesëmarrësit.

Përdoruesi merr masa për hartimin e planit të emergjencës dhe evakuimit dhe është i detyruar të lidhë policë sigurimi për dëmet ndaj palëve të treta dhe objektit gjatë periudhës së kampit.

**Neni 9**
**Mosmarrëveshjet**

Palët përpiqen të zgjidhin çdo mosmarrëveshje në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk arrihet, mosmarrëveshjet i nënshtrohen juridiksionit të gjykatës kompetente.

**Neni 10**
**Dispozita të fundit**

Kontrata që do të jetë burim i kësaj marrëveshje të miratuar nga Këshilli Bashkiak Tepelenë jepet me kusht të panegociueshëm se në cdo rast që Bashkia Tepelenë do të ketë nevojë të përdor këto hapësirë për mësimdhënie, e cila mund të vij si rezultat i rritjes së numrit të nxënësve marrëveshja **do të prishet në mënyrë të njëanshme dhe objekti do të vihet në dispozicion të shkollës (Zyrës Arsimore).** Efektet ekonomike ose dëmet e që mund të shkaktohen nga ky kusht do të vlerësohen në bazë të shpenzimeve të kryera nga organizata për aq kohë sa ajo e ka përdorur.

Çdo ndryshim tjetër kësaj marrëveshje e cila do të referohet në kontratën e lidhur midis Bashkisë Tepelenë dhe Qendrës ACEG bëhet me marrëveshje të palëve dhe miratim të Këshillit Bashkiak, në formë shkresore.

Kontrata do të hartohet në tre kopje origjinale, nga të cilat secila palë mban një kopje.

**Dhënësi i pronës**

Kryetari i Bashkisë Tepelenë
Gramoz Sako

**Përdoruesi (ACEG)**

Drejtor Ekzekutiv
Margarita Buxhaku

**Aneks A – Planvendosja e objektit**

*(I referohet Relacionit Teknik të paraqitur nga Kryetari Bashkisë bashkëlidhur propozimit për marrjen e këtij projekt-vendimi.)*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË

Nr 564......Prot

Tepelenë më, 24.3.2026

# RELACION

Për Projekt Vendimin Nr. ___________ datë _______________

**"Për dhënien në përdorim pa kundërshpërblim në favor të Qendrës "ACEG", një pjesë të objektit publik shkolla 9-vjeçare "Asim Zeneli, fshati Progonat Bashkia Tepelene , dhe miratimit të marrëveshjes së bashkëpunimit që do të nënshkruhet për këtë qëllim"**

## I.QËLLIMI I PROJEKT VENDIMIT

Për realizimin e projektit edukativ dhe social , i cili synon zhvillimin e aktiviteteve edukative, sportive, kulturore dhe mjedisore për fëmijë dhe të rinj. Bashkia Tepelenë të mundësojë dhënien në përdorim, një pjesë të objektit "Shkolla 9-vjeçare Asim Zeneli" dhe oborrin e saj në fshatin Progonat.

Aktivitetet do të përfshijnë:

- edukim mjedisor dhe njohjen e natyrës
- aktivitete sportive dhe rekreative
- aktivitete artistike dhe kulturore
- njohjen e traditave dhe jetës rurale të zonës së Kurveleshit.

Realizimi i këtij projekti synon:

- rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të papërdorura të objektit publik
- zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe sociale për të rinjtë
- promovimin e zonës së Kurveleshit si destinacion i turizmit të natyrës
- përfshirjen e komunitetit lokal në aktivitete ekonomike dhe sociale
- krijimin e mundësive të punësimit sezonal për banorët e zonës.

Projekti kontribuon në gjallërimin social dhe ekonomik të zonës dhe në përdorimin më efikas të pasurive publike të Bashkisë Tepelenë.
Veprimtaria zhvillohet pa qëllim fitimi, dhe në interes të komunitetit lokal.

**II.ARGUMENTIMI I PROJEKT VENDIMIT** lidhur me përparësitë, problematika , efektet e pritshme.

Pranë Bashkisë Tepelenë ,ështtë dorëzuar një kërkesë për bashkëpunim dhe zbatim të një projekti kamp veror edukativ në fshatin Progonat/Njësia Adm. Kurvelesh. prej: Qendra Albanian Center for Environmental Governance (ACEG), person juridik jofitimprurës me NIPT L62011451I, me adresë Rruga "Qemal Stafa", Tiranë, përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive Znj. Margarita Buxhaku, **protokolluar me tonën nr 180 , datë 26.01.2026 .**

Nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar : "Projekt Propozimit për kamp veror në katin e dytë të shkollës së Progonatit" , ky projekt synon që në kuadër të promovimit të turizmit të qëndrueshem dhe zhvillimit rural në Kurvelesh , të rigjallërojë një nga ndërtesat pronë e Bashkisë Tepelene , katin e dytë të shkollës 9-vjeçare "Asim Zeneli" Progonat .

Kryetari i Bashkisë duke vlerësuar këtë shprehje të interesit , me urdhërin nr 30 , datë 19.02.2026, ka ngritur grupin e punës "Për verifikimin e gjendjes faktike, teknike, funksionale dhe statusit juridik të objektit publik shkollës 9-vjeçare "Asim Zeneli" Progonat.me detyra të qarta të caktuara.

Ky komision , pas vlerësimit dhe verifikimit në vend ka përgatitur Relacionin teknik , nr 395/1 prot, datë 20.02.2026. ( bashkëlidhur)

Sipas këtij relacioni

1. Pasuria me nr 682 dhe siperfaqe ndërtimi 507 m2 , ka statusin juridik në pronësi të bashkisë Tepelene dhe me funksion zhvillim të veprimtarisë arsimore.
2. Godina e shkollës është pjesërisht funksionale për procesin mësimor e ndarë funksionalisht nga ambientet e paërdorëshme .
3. Pjesa tjetër e ambienteve kati parë dhe i dytë, rezultojnë të papërdorëshme ose të nënshfrytëzuara. Ambientet e papërdorëshme paraqesin amortizim të zakonshëm nga përdorimi dhe mosmirëmbajtja periodike, nuk paraqesin rrezik strukturor të dukshëm, janë në gjendje të qëndrueshme muret, dyshemetë, tavani, ndërsa dritaret, dyert, dhe instalimet kanë nevojë për përmirësime dhe për. Oborri i shkollës dhe hapësirat përreth janë të aksesueshme dhe nuk janë të zëna nga aktivitete të përhershme dhe të përshtatshme për aktivitete kulturore-sportive.
4. Bazuar në këtë relacion, konstatohet se pjesa e paërdorëshme të objektit shkollë 9-vjeçare A.Zeneli" është në kushte të përshtatshme për përdorim sezonal, me kusht që të kryhen ndërhyrje rehabilituese dhe të respektohen standartet e sigurisë dhe mirëmbajtjes.

Gjithashtu, nga ana e grupit, i është kërkuar dhe një informacion në formë opinioni , lidhur me përdorimin e këtij ambienti të shkollës 9-vjeçare , ZVA Tepelenë me shkresën nr 367 prot, datë 17.02.2026. ZVA Tepelenë me shkresën e saj nr 152 prot, datë 23.02.2026 , ka përcjellë dakortësinë e saj për shfytëzim të mjediseve të katit të dytë, ku nuk zhvillohet mësim apo ndonjë veprimtari tjetër shkollore, dhe për më tepër që këto mjedise po amortizohen me shpejtësi duke rrezikuar mjediset e katit të parë ku po zhvillohet procesi mësimor.

Rëndësia e këtij projekti, interesi publik dhe përfitimi për Bashkinë

Projekti kontribuon në gjallërimin social dhe ekonomik të zonës dhe në përdorimin më efikas të pasurive publike të Bashkisë Tepelenë.

- rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të papërdorura të objektit publik
- zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe sociale për të rinjtë
- promovimin e zonës së Kurveleshit si destinacion i turizmit të natyrës
- përfshirjen e komunitetit lokal në aktivitete ekonomike dhe sociale
- krijimin e mundësive të punësimit sezonal për banorët e zonës.

Përdorimi i objektit kufizohet në ambientet e papërdorura të shkollës dhe nuk cenon zhvillimin e procesit mësimor.

Çdo investim i kryer nga Përdoruesi në objekt mbetet pronë e Bashkisë Tepelenë pas përfundimit të afatit të përdorimit, pa të drejtë kompensimi.

Veprimtaria zhvillohet pa qëllim fitimi, në përputhje me statutin e organizatës ACEG dhe në interes të komunitetit lokal.

## III.VLERESIMI I LIGJSHMËRISË

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pikat 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 54, shkronjat “e/1”, “f” dhe “k”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenet 901-912, të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, Ligjin nr. 8788/2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, Udhëzimin nr. 21, datë 23.08.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për përdorimin e ambienteve të institucioneve arsimore parauniversitare jashtë orarit mësimor.

Nga pikëpamja institucionale, iniciativa është në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon administrimin e pronave publike dhe aktivitetin e organizatave jofitimprurëse në Shqipëri. Këshilli i Bashkisë Tepelenë ka kompetencë të plotë për të vendosur përdorimin e përkohshëm të pronave publike për aktivitete me interes publik që kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit.

## IV.PËRMBLEDHJE SPJEGUESE E PROJEKT AKTIT

Pika 1 e projekt vendimit parashikon Dhënien në përdorim pa kundërshpërblim në favor të Qendrës "ACEG", një pjesë të pasurisë me numër 682 dhe siperfaqe ndërtimore 507 m2 të objketit shkolla 9-vjeçare "A.Zeneli" , përkatësisht kati i dytë, duke përmbajtur plotësisht dhe konform parashikimeve të marrëveshjes së bashkëpunimit e cila do të diskutohet dhe miratohet nga Këshilli i Bashkisë , që do të nënshkruhet për këtë qëllim, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Pika 2, ngarkon kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij për nënshkrimin e marrëveshjes së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

Pika 3 , ngarkon Bashkinë Tepelenë të ndjek procedurën sipas parashikimeve të këtij vendimi, si dhe nxjerrjen e çdo akti të nevojshëm për zbatimin e tij.

Pika 4, parashikon që për zbatimin e këtij vendimi , kryetari i Bashkisë, Drejtoria e ligjore dhe shërbimeve Organizative, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit Sportit dhe Kujdesit Shoqëror, për zbatimin e këtij vendimi.

## V.GRUPI I PUNËS QË PËRGATITI MATERIALIN ,

Ngarkuar me urdhërin nr 30 , datë 19.02.2026, ka ngritur grupin e punës "Për verifikimin e gjendjes faktike, teknike, funksionale dhe statusit juridik të objektit publik shkollës 9-vjeçare "Asim Zeneli"

## VI.REALIZIMI I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projekt vendim nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e Bashkisë Tepelenë.

Grupi i punës

Albion Tahmazi

Nr. 180
26.01.2026

– Z. Toti
për ndjekje
26.01.2026

ACEG
ALBANIAN CENTRE for ENVIRONMENTAL GOVERNANCE

Prot.nr. /2026

Dt. 22.01.2026

## KËRKESË

**Drejtuar:**

**Z. Gramoz Sako**
Kryetar i Bashkisë Tepelenë

**Lënda**: Kërkesë për bashkëpunim për shndërrimin e katit të dytë të shkollës "Asim Zeneli" në fshatin Progonat në kamp veror edukativ.

**I nderuar kryetar Sako,**

Qendra ACEG është një organizatë jo-fitimprurëse që vepron në fushën e qeverisjes mjedisore, zhvillimit rural dhe turistik, angazhimit dhe promovimit të të rinjve për një zhvillim të qëndrueshëm.
Në kuadër të promovimit të turizmit të qëndrueshëm dhe zhvillimit rural në Kurvelesh, kemi hartuar një Studim Fizibiliteti dhe Planin e Biznesit për shndërrimin e katit të dytë të ndërtesës së shkollës "Asim Zeneli" në fshatin Progonat në një kamp veror për nxënës të shkollave.

Sipas studimit, projekti parashikon:

- **Rregullimin e objektit**, punime rehabilituese (izolim, riparim), zëvendësim dritaresh aty ku duhet, instalime elektrike dhe hidrike, pajisje të reja sanitare.
- Shndërrimin e katit të parë në kuzhinë dhe restorant, sallë ngrënieje dhe hapësirë komunitare.
- **Akomodimin e grupeve** prej 20–25 nxënësish për turne një-javore. Secila dhomë pajiset me katër krevate marinari dhe strehohen deri në tetë persona duke respektuar standardin e hosteleve (≥3 m² për person) dhe raportin një dush për 10 persona.
- **Programin edukativ** që përfshin ekskursione në Kanionin e Progonatit dhe Nivicës dhe ujëvarat e zonës, takime dhe trajnime rreth biodiversitetit dhe kulturës lokale, aktivitete sportive dhe kulturore dhe kontribute të punës komunitare.
- **Punësimin e stafit lokal**, mësues, guida turistike, kuzhiniere dhe punonjës mirëmbajtjeje.

Projekti synon të rigjallërojë një ndërtesë bashkiake të amortizuar duke krijuar një qendër edukative dhe turistike, me përfitime sociale dhe ekonomike për komunitetin dhe Bashkinë Tepelenë.

**Plani i biznesit në përmbledhje përmban:**

- **Kapaciteti:** 6 dhoma x 8 shtretër = 48 persona; grupet e rekomanduara 20–25 nxënës për turne.
- **Shkalla e zënies (occupancy rate):** parashikohet rreth 60 % për sezonin e parë (rreth 15 nxënës për turne).
- **Sezoni i operimit:** qershor – gusht (10 turne njëjavore).
- **Tarifa e pjesëmarrjes:** 400 - 450 € për nxënës (përfshin akomodim, ushqim, guida dhe aktivitete).
- **Të ardhurat sezonale:** me zënien 60 % pritet të gjenerohen rreth 52 000 € në total (p.sh., 15 nxënës × 450 € × 10 turne).
- **Shpenzimet kryesore**: ushqimi (28 000–35 000 €), paga e stafit (24 400 €), utilitete (3 000 €), aktivitete dhe shpenzime të tjera (3 500 €) dhe shpenzime dhe investime të tjera kulturore si panaire dhe promovime.
- **Rezultati financiar:** Të ardhurat mbulojnë shpenzimet operative duke garantuar qëndrueshmëri financiare dhe sociale-edukative në përputhje me misionin e Organizatës tonë.

Projekti është financiarisht i qëndrueshëm, krijon vende pune lokale dhe gjeneron të ardhura për Bashkinë Tepelenë nëpërmjet rehabilitimit të godinës, turizmit, punësimit, shitjes së produkteve vendore, rigjallërimit të jetës komunitare. Për më tepër ky projekt synon të krijoj një model të suksesshëm për zonën dhe gjithë Shqipërinë përmes bashkëpunimit bashki- organizata joqeveritare-komunitet.

Duke konsideruar sa më sipër, Qendra ACEG kërkon dhënien në përdorim të katit të parë dhe tretë të shkollës 'Asim Zeneli', Progonat, gjatë periudhës së pushimeve verore, për zhvillimin e një kampi veror edukativ, jo-fitimprurës, në funksion të interesit publik dhe zhvillimit komunitar.

Ju lutem gjeni bashkëngjitur studimin e fizibilitetit dhe mbetemi në dispozicion për sqarime shtesë dhe presim me interes bashkëpunimin për të sjellë në jetë këtë projekt me vlerë të lartë edukative dhe turistike.

Me respekt,

Margarita Buxhaku

Margarita Buxhaku
Drejtore Ekzekutive

Qendra ACEG,
E-mail: info@aceg.al
Tel: +355 (0) 69 35 29 375
Htpp://www.aceg.al
NIPT L62011451I,
Adresa: Rruga "Qemal Stafa", Pall.343.Shk. 6.K.1, Tirane

E-mail: info@aceg.al
ACEG
NIPT: L62

# PROJEKT PROPOZIM

për

Kamp Veror në katin e dytë të shkollës së Progonatit



Figure 1. Foto e godinës ekzistuese. Shkolla Asim Zeneli Progonat

Adresa | Rruga "Qemal Stafa, Pall. 343, Shk.6, K.1, Tiranë | info@aceg.al

## TABELA E PËRMBAJTJES


LISTA E TABELAVE ... 3
PJESA A ... 5
**1. Përmbledhje ekzekutive** ... 4
**2. Konteksti lokal dhe kërkesa për turizëm** ... 5
2.1 Konteksti gjeografik ... 5
2.2 Burimet Ekonomike Lokale që Mbështesin Kampin ... 6
**3. Përshkrim i përgjithshëm infrastrukturor** ... 8
3.1 Përshkrim godinës ekzistuese ... 8
3.2 Planvendosja e re ... 9
3.3 Investimi dhe rehabilitimi i objektit ... 9
**4. Plan operativ dhe stafi** ... 10
4.1 Kapaciteti dhe turnet ... 10
4.2 Personeli ... 10
**5. Aktivitetet dhe atraksionet** ... 12
Pjesa B ... 13
**6. Plani i Biznesit** ... 13
6.1 Supozimet e këtij modeli ... 13
6.2 Të ardhurat sezonale ... 13
6.3 Struktura e kostove operative (OPEX) ... 14
6.4 Rezultati financiar – Skenari bazë (100% mbushje) ... 14
6.5 Analiza e ndjeshmërisë. Skenari realist (60% mbushje) ... 15
6.7 Politika financiare dhe natyra jo-fitimprurëse ... 15
6.8 Përfundim financiar ... 16
**7. Përfitimet për Bashkinë dhe komunitetin** ... 16
**8. Përfundim** ... 16
**9. REFERENCA DHE BURIME** ... 18

# LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Kosto e investimit vlerësim paraprak. ........................................... 10
Tabela 2. Parametrat kryesorë të funksionimit sezonal ............................. 13
Tabela 3. Të ardhurat nga aktiviteti i kampit ................................................ 14
Tabela 4. Shpenzimet operative sezonale (OPEX) ...................................... 14
Tabela 5. rezultati financiar sezonal ............................................................. 14
Tabela 6. Skenari realist i pjesëmarrjes ....................................................... 15
Tabela 7. – Rezultati financiar në skenarin 60% ......................................... 15
Tabela 8. Pika e barazimit ............................................................................ 15

# 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim fizibiliteti paraqet analizën e plotë teknike, infrastrukturore, operative dhe financiare për shndërrimin e katit të dytë të shkollës "Asim Zeneli" në Progonat në një Kamp Veror edukativ dhe komunitar për nxënës të shkollave të mesme. Projekti synon rikthimin në funksion të një prone publike të nënshfrytëzuar, duke e kthyer atë në një qendër akomodimi dhe mësimi në natyrë, me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit arsimor, punësimin lokal dhe forcimin e ekonomisë së zonës së Kurveleshit.

Investimi i parashikuar për rehabilitimin e objektit vlerësohet rreth 43 000 euro dhe përfshin riparime strukturore, pajisje akomodimi, instalime sanitare, mobilim të kuzhinës dhe sallës së ngrënies, si dhe pajisje sigurie në përputhje me standardet bazë të qendrave edukative dhe hosteleve. Pas rikonstruksionit, objekti do të ofrojë kapacitet maksimal prej 48 shtretërish dhe do të funksionojë me turne njëjavore gjatë sezonit veror (qershor–gusht), me rreth 10 turne dhe grupe mesatare prej 15 nxënësish.

Analiza e tregut dhe e kontekstit lokal tregon se zona e Kurveleshit, me atraksione natyrore si Kanionet e Nivicës, ujëvarat dhe trashëgiminë kulturore, përbën një mjedis shumë të përshtatshëm për zhvillimin e turizmit edukativ dhe të aventurës. Projekti mbështetet fuqimisht në burimet vendore: stafi rekrutohet nga komuniteti, furnizimi ushqimor realizohet nga fermerët lokalë dhe aktivitetet drejtohen nga guida vendase, duke krijuar punësim sezonal dhe të ardhura shtesë për familjet e zonës.

Modeli financiar është ndërtuar mbi parimin jo-fitimprurës dhe synon vetë-qëndrueshmërinë e aktivitetit. Tarifa e pjesëmarrjes prej 400 euro për nxënës në javë përfshin akomodimin, ushqimin, programin edukativ, guidat dhe aktivitetet. Në skenarin optimal me mbushje të plotë të kapacitetit (150 nxënës në sezon), të ardhurat sezonale arrijnë 60,000 euro, ndërsa shpenzimet operative vlerësohen 56,500 euro, duke krijuar një tepricë minimale sigurie prej 3 500 euro për mirëmbajtje dhe stabilitet financiar. Analiza e ndjeshmërisë tregon se projekti është i qëndrueshëm financiarisht vetëm me një normë të lartë mbushjeje, ndërsa pika e barazimit arrihet me rreth 141 nxënës në sezon (afërsisht 94% e kapacitetit).

Në përfundim, studimi konfirmon se Kampi Veror në Progonat është një projekt teknikisht i realizueshëm, financiarisht i kontrolluar dhe socialisht i dobishëm, i cili kontribuon në zhvillimin ekonomik lokal, edukimin mjedisor të të rinjve dhe promovimin e trashëgimisë natyrore e kulturore të zonës. Bashkia Tepelenë përfiton nga të ardhurat e rritur atë turizmit, investimin në godinë të amortizuar, ndërsa komuniteti lokal përfiton nga punësimi sezonal, shitja e produkteve dhe promovimi i trashëgimisë kulturore. Kjo përmbledhje thekson se projekti është ekonomikisht i qëndrueshëm, i dobishëm dhe në përputhje me legjislacionin për vetëqeverisjen vendore si paketa e maleve, zhvillimi ekonomik vendor dhe promovimi i turizmit.

## PJESA A

# 2. KONTEKSTI LOKAL DHE KËRKESA PËR TURIZËM

## 2.1 Konteksti gjeografik

Progonati ndodhet në zonën malore të Kurveleshit, pjesë e Bashkisë Tepelenë. Sipas të dhënave historike, Progonati ka qenë fshati më i madh i Kurveleshit dhe qendra e ish-komunës deri në vitin 1992. Bashkia Tepelenë raporton rritje të interesit për turizmin malor. Në vitin 2025, qyteti ofron mbi 40 njësi shërbimi me rreth 400 shtretër, kryesisht në zonën e Kurveleshit. Shtimi i vizitorëve në kanionet e Progonatit dhe Nivicës ka nxitur investime në fshatrat Rexhinë, Gusmar, Progonat dhe Nivicë.

Mbështetja për komunitetet, modelet e turizmit komunitar në jug të Shqipërisë tregojnë se vizitorët qëndrojnë për kulturën dhe traditat lokale. Për shembull, Përmeti (rreth 150 000 vizitorë në vit) dhe Gjirokastra tregojnë se krijimi i **përvojave autentike rrit të ardhurat dhe ruan identitetin kulturor.**

Në rajonin e Kurveleshit (zona malore ku ndodhet Progonati) gjenden edhe atraksione të tjera që mund të përfshihen në programet e kampit. Për shembull, Kanionet e Nivicës (në fshatin Nivicë, i afërt me Progonatin) ofrojnë peizazhe dramatike shkëmbore dhe shtigje për ecje në natyrë. Zona e Kurveleshit në përgjithësi është e pasur me shpella karstike; pranë Progonatit ndodhet shpella "Mema e Ujit", e gjatë mbi 800 metra dhe e zbukuruar me stalaktite – një mundësi interesante eksplorimi speleologjik me ndihmën e guidave lokale. Fshatrat përreth si Nivica, Gusmar, Lekdush etj. kanë kulla karakteristike guri dhe rrënoja historike, përfshirë kisha të vjetra ortodokse dhe teqe bektashiane, që pasqyrojnë trashëgiminë kulturore të zonës. Vetë fshati Progonat ishte historikisht një qendër e rëndësishme e Kurveleshit; ai njihet për kontributet në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe për rezistencën ndaj pushtuesve. Një "Kullë e ngujimit" (kullë mbrojtëse) dhe struktura të tjera tradicionale ende qëndrojnë në fshat si dëshmi e asaj historie. Këto vende mund të vizitohen me guida lokale, të cilët mund të tregojnë histori e legjenda të zonës. Për adhuruesit e natyrës së egër, malet e Kurveleshit strehojnë faunë të rrallë – sytë e vëmendshëm (dhe me fat) mund të dallojnë gjurmë ariu të murrmë apo ujku në pyjet e thella, duke reflektuar shkallën e ruajtjes së natyrës në këto male.

Mundësi aktivitetesh natyrore dhe guida lokale: Kombinimi i atraksioneve të lartpërmendura e bën Progonatin një bazë ideale për **eko-turizëm dhe aventurë**. Kampi mund të organizojë ekskursione ditore me ecje (hiking) drejt ujëvarave, kanioneve dhe majave malore përreth. Ka mundësi për piknikë në natyrë, vëzhgim shpendësh dhe kamping të kontrolluar. Guida lokale – banorë të zonës me përvojë – mund të angazhohen për të udhëhequr vizitorët në

shtigjet malore, duke garantuar siguri dhe duke ndarë njohuritë e tyre për florën, faunën dhe kulturën lokale. Për shembull, një guidë lokale mund të shoqërojë grupet e kampit në Ujëvarën e Peshturës duke treguar rrugën e duhur dhe duke rrëfyer histori si ajo e vendit "Buza e Ujit" apo tregime për kohët kur këto shtigje përshkoheshin nga karvanët e tregtarëve. Po ashtu, guida me eksperiencë mund të ofrojnë ture me mushka drejt destinacioneve më të largëta (staneve) e terreneve të vështira, çka e shton aventurën. Bashkëpunimi me guidat lokale jo vetëm pasuron përvojën e vizitorëve, por edhe krijon punësim sezonal për të rinjtë dhe banorët e zonës.

## 2.2 Burimet Ekonomike Lokale që Mbështesin Kampin

Për funksionimin e suksesshëm të kampit gjatë gjithë vitit, është e nevojshme të mbështetet në burimet dhe kapacitetet vendore. Zona e Progonatit dhe Kurveleshit disponon disa pasuri ekonomike lokale, të cilat mund të integrohen në aktivitetin e kampit për të siguruar furnizime cilësore, shërbime autentike dhe një eksperiencë të vërtetë vendore për vizitorët. Këtu identifikojmë disa prej tyre:

**Bujqësia dhe produktet ushqimore vendore**: Progonati gjendet në 900 m lartësi dhe ka traditë në prodhimet blegtorale dhe bujqësore malore. Edhe sot në fshat operojnë disa prodhues të djathit dhe bletërritës që nxjerrin mjaltë cilësor. Produktet e bulmetit (djathi i bardhë i deleve dhe dhive, gjalpi i freskët, kos i trashë), mjalti i malit, si dhe çaji i malit, janë ndër specialitetet e zonës. Përveç tyre, Progonati është i njohur për pemët frutore të përshtatura me klimën malore – gështenja, arra dhe qershi të egra rriten me bollëk në këtë trevë. Këto produkte mund të përdoren drejtpërdrejt në kuzhinën e kampit, duke ofruar vakte me ushqime bio e tradicionale për pjesëmarrësit (p.sh. byrekë me zarzavate mali, mish keci në tavë me arra, reçel shtëpie nga qershitë e egra, etj.). Furnizimi i kampit me ushqime vendore jo vetëm siguron freski dhe cilësi, por edhe gjeneron të ardhura për fermerët lokalë. Një model i tillë "farm-to-table" (nga ferma në tryezë) mund të bëhet pjesë e identitetit të kampit, ku fëmijët/ të rinjtë gjithashtu mund të angazhohen në mësimin e procesit të përgatitjes së djathit ose mbledhjes së mjaltit si aktivitet edukativ.

**Artizanati dhe zejet tradicionale**: Krahinat e Labërisë dhe Kurveleshit kanë tradita të vjetra artizanale, të cilat mund të shfrytëzohen si atraksion kulturor dhe burim ekonomie. Punimet e drurit dhe gurit janë ndër mjeshtëritë tradicionale të jugut – artizanë lokalë mund të prodhojnë suvenire si kuti druri të gdhendura, lugë ose enë tradicionale, ornamente prej guri ose qeramike të punuara me motive lokale. Gratë e zonës mund të ofrojnë punime tekstili si qilima të vegjël, rrugica leshi, qëndisma apo veshje tradicionale (kostume popullore të zonës së

Labërisë). Kampi mund të krijojë një kënd ku ekspozohen dhe shiten këto produkte artizanale, në mënyrë që vizitorët të mund të marrin me vete një kujtim lokal. Gjithashtu, mund të organizohen punëtori artizanati (ëorkshops) gjatë qëndrimit, ku fëmijët apo turistët të provojnë vetë p.sh. të thurin një shportë me thupra, të ndërtojnë një vegël muzikore (si fyell apo defi) ose të mësojnë elementë të valle tradicionale të trevës. Këto aktivitete angazhojnë mjeshtrit vendas si instruktorë, duke u siguruar atyre honorare dhe duke ruajtur gjallë traditat.

**Shërbimet e guidave dhe edukatorëve lokalë**: Siç u përmend më sipër, potenciali natyror dhe historik i zonës mundëson punësimin e guidave turistike lokale. Të rinj nga zona mund të trajnohen për t'u bërë guida natyre, shoqërues malorë (p.sh. njohës të mirë të shtigjeve drejt kanioneve e ujëvarave) apo tregimtarë të historisë lokale për vizitorët. Këto guida mund të kontraktohen nga kampi me pagesë ditore sa herë organizohen ture, duke siguruar që komuniteti lokal të ketë përfitim direkt nga aktiviteti turistik. Po ashtu, edukatorë lokalë – p.sh. mësues të shkollës së fshatit, apo intelektualë që vijnë nga Progonati – mund të përfshihen në programin e kampit gjatë vitit. Ata mund të drejtojnë ligjërata tematike për fëmijët (p.sh. mbi historinë e krahinës, mbi florën dhe faunën vendase, folklorin e Labërisë etj.), ose të ndihmojnë në realizimin e punëtorive edukative. Angazhimi i tyre ka dy anë pozitive: i jep kampit staf me njohuri kontekstuale dhe një "fytyrë lokale", ndërsa u siguron atyre të ardhura suplementare dhe i motivon të ruajnë e përcjellin trashëgiminë e zonës.

**Akomodimi dhe infrastruktura ekzistuese lokale**: Në vetë fshatin Progonat dhe rrethin
at kanë filluar të shfaqen elemente të infrastrukturës turistike. Ekzistojnë disa bujtina familjare (guesthouses) të ndërtuara në stilin tradicional prej guri, ku mund të akomodohen vizitorë nëse kapaciteti i kampit nuk mjafton. Për shembull, një "Progon House" ofron dhoma familjare me kushte moderne në një ndërtesë karakteristike të zonës. Këto bujtina mund të bashkëpunojnë me kampin për strehimin e vizitorëve shtesë gjatë eventeve më të mëdha apo në sezonin turistik. Po ashtu, familjet vendase shpesh janë të gatshme të marrin pjesë në skemën e mikpritjes familjare (homestay) për vizitorët që dëshirojnë eksperiencë më autentike – kampi mund të veprojë si ndërmjetës duke lidhur vizitorët (p.sh. alpinistë, studiues ose turistë individualë) me familjet që ofrojnë fjetje e ushqim kundrejt pagesës. Kjo e shpërndan impaktin ekonomik dhe nxit banorët të përmirësojnë kushtet e banesave të tyre për turizëm.

**Gastronomia lokale dhe produktet artizanale ushqimore**: Veç produkteve bazë, zona mund të ofrojë edhe produkte të përpunuara artizanale: për shembull, gratë e fshatit mund të përgatisin gliko (reçelra frutash, sidomos gliko qershie e arre që janë tradicionale për jugun),

liko trëndafili, turshi të ndryshme, si dhe pije alkoolike si raki mani, rrushi apo thane. Këto mund të paketohen në sasi të vogla dhe të shiten tek vizitorët e kampit si suvenire gastronomike. Një treg i vogël brenda kampit ose në oborrin e shkollës gjatë eventeve kulturore mund të ekspozojë këto mallra "Made in Progonat". Kjo stimulon veçanërisht gratë dhe grupet e margjinalizuara të marrin pjesë në ekonominë e kampit.

Në përgjithësi, integrimi i burimeve lokale e bën kampin një faktor zhvillimi për komunitetin: shumica e të ardhurave që gjeneron turizmi do të qarkullojnë në fshat (për ushqime, shërbime, artizanë, guida), duke krijuar vende pune dhe duke incentivuar të rinjtë të qëndrojnë apo të kthehen në fshat. Një model i tillë i suksesshëm rrit ndjenjën e pronësisë së komunitetit ndaj kampit – banorët do ta shohin kampin si diçka të tyrën dhe do të jenë të motivuar ta mirëmbajnë e ta përmirësojnë vazhdimisht.

# 3. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM INFRASTRUKTUROR

## 3.1 Përshkrim godinës ekzistuese

Godina dykatëshe që ndodhet në Progonat është një ndërtesë e amortizuar, ku në katin e aprë zhvillohet mësim i shkollës 9-vjeçare për një numër të vogël nxënësish të grumbulluar në 2 klasa vetëm. Korridoret e gjerë, dhomat 30 m² dhe oborri i madh e bëjnë të përshtatshme për t'u shndërruar në një kamp edukativ për nxënës të shkollave të mesme nga e gjithë Shqipëria. Pjesa e sipërme (kati i dytë) do të rikonceptohet si hapësirë akomoduese, ndërsa kati i parë (pjesërisht) do të shërbejë si restorant, kuzhinë dhe hapësirë komunitare. Projekti synon që me një investim modest (40 000–50 000 €) të ringjallë godinën duke përfituar nga turizmi arsimor dhe natyror në Kurvelesh. Të ardhurat do të sigurohen nga tarifat e pjesëmarrjes (400 € për nxënës në javë) dhe përdorimi i burimeve dhe stafit lokal do të ulë kostot e operimit.

Objekti aktual ka tre kate të ndara. Muret dhe çatia janë në gjendje relativisht të mirë, por suvatimi, dritaret dhe instalimet janë të amortizuara. Kati i tretë ka gjashtë dhoma prej rreth 30 m² secila në katin e dytë dhe hapësira më të mëdha në katin përdhes. Për të dhënë një ide të gjendjes ekzistuese, më poshtë paraqitet një foto e godinës para rehabilitimit (foto e vjetër). Kjo pamje tregon mungesën e izolimit, bojën e dëmtuar dhe pamjen e amortizuar të fasadës. Sipas standardeve të hosteleve, çdo dhomë duhet të ofrojë të paktën 3 m² për person dhe dritë natyrale. Kati i dytë do të riorganizojë banjot për të respektuar normat për tualetet dhe dushët (një dush për çdo 10 persona dhe dy tualete për 10 personat e parë).

## 3.2 Planvendosja e re

Propozimi i ri i planit mban strukturën ekzistuese, por organizon dhomat dhe banjot në mënyrë optimale. Korridori i qendrës lehtëson hyrjen në secilën dhomë, ndërsa në fund të korridorit vendosen tualetet dhe dushët e ndara për vajza e djem. Kati i parë shërben për kuzhinën dhe sallën e ngrënies me një magazinë dhe zyrë të vogël. Skema më poshtë është një plan i thjeshtë ilustrues i katit të dytë (akomodimi) dhe katit të parë (kuzhinë/restorant).




## 3.3 Investimi dhe rehabilitimi i objektit

Rehabilitimi synon ruajtjen e karakterit të godinës dhe përmirësimin e funksionaliteteve. Figura më poshtë paraqet një vizualizim të mundshëm të objektit pas rikonstruksionit: fasada është suvatosur dhe lyhet me ngjyrë neutrale, çatia mbulohet me tjegulla të kuqe, dritaret janë të reja me xham termik dhe shtohet një hyrje më e madhe me platformë për personat me aftësi të kufizuar. Poshtë jepet planimetria dhe shembuj të dhomave të akomodimit dhe kuzhinës/sallës së ngrënies që synohet të arrihen.



Në dhomat e akomodimit do të vendosen krevate marinari prej druri, tavolina dhe rafte. Krevate të tilla krijojnë hapësirë për 8 persona në secilën dhomë. Salla e ngrënies do të pajiset me tavolina të gjata prej druri dhe karrige; kuzhina me soba industriale, frigoriferë dhe lavastovilje.

**Kosto e investimit ( vlerësim paraprak 43,000 €)**

| **Zëri i investimit** | **Përshkrimi i shkurtër** | **Vlera e përafërt (EUR)** |
|---|---|---|
| Riparime strukturore | Rikonstruksion i çatisë, izolim termik, suvatim dhe bojë, sistem parket melamin, shkalla? | 20 000 |
| Pajisje dhomash | Krevate marinari, dyshekë, dollapë, tavolina, drita e perde | 7 000 |
| Sanitarë dhe kanalizime | Instalime të reja për tualete dhe dushë, ndarje për vajza/djem | 5000 |
| Pajisje kuzhine | Soba industriale, frigoriferë, lavastovilje, tavolina pune | 4 500 |
| Mobilim salle ngrënieje | Tavolina e karrige për 30–40 persona | 2 500 |
| Siguri dhe emergjenca | Sisteme zjarrfikëse, alarme tymi, ndriçim emergjence, dalje sigurie. | 2 000 |
| Dokumentacion dhe leje | Projektim, supervizim, taksa të lejes së rikonstruksionit | 2 000 |
| **Total** | | **43 000** |

**Tabela 1. Kosto e investimit vlerësim paraprak.**

# 4. PLAN OPERATIV DHE STAFI

## 4.1 Kapaciteti dhe turnet

Kati i dytë përmban gjashtë dhoma prej ~30 m² secila. Çdo dhomë do të ketë katër krevate marinari që strehon 8 nxënës, kështu kapaciteti maksimal i katit është 48 persona. Për të siguruar hapësirë të mjaftueshme për aktivitete, sugjerohen grupe prej 20–25 nxënësish për turne njëjavore (7 ditë/6 net). Sezoni i veprimtarisë parashikohet nga qershori deri në gusht, me rreth 10 turne gjatë verës.

## 4.2 Personeli

Stafi do të rekrutohet nga komuniteti lokal për të ulur kostot dhe për të rritur përfitimet lokale.




Struktura e propozuar:

**Menaxher/drejtues kampi** me kohë të plotë 12 muaj duke përfshirë kohën e përgatitjes, gjatë kampit dhe pas kampit, marrëdhënies me prindërit, institucionet, sigurisë, marketingut dhe promovimit.

**3 mësues/**: do të drejtojnë aktivitetet edukative dhe do të monitorojnë nxënësit. Duke qenë lokalë, paga mujore parashikohet 700 €, për tre muaj (totali 6300 €).
**2 guida/punonjës socialë**: organizojnë ekskursione në Kanionin e Progonatit dhe Nivicës, ujëvarën e Peshturës, vizita malore, dhe aktivitete sociale; paga 400-500 €/muaj, tre muaj (totali 3 000 €).

**2 kuzhiniere/punonjës kuzhine**: përgatitin vakte me produkte lokale; paga 900 €/muaj, tre muaj (totali 5400 €).

**Mirëmbajtje dhe shërbime**: një punonjës teknik dhe pastrim; paga 500 €/muaj, tre muaj (totali 1,500 €).

**Roje nate (dëzhur**) me pagë 400 € në muaj totali 1200€.

Shpenzimet totale të stafit për **sezonin llogariten rreth 24 000 €.** Përdorimi i stafit lokal ul nevojën për akomodim shtesë dhe ofron të ardhura për familjet e zonës.

## 5. AKTIVITETET DHE ATRAKSIONET

Programi i kampit do të përfshijë këto por dhe të tjera që do të detajohen në programin specifik:

- **Ekskursione natyrore**: vizita në Kanionin e Progonatit dhe Nivicës, një atraksion prej 40 km me 11 ujëvara ku më e larta arrin 220 m; shëtitje drejt ujëvarës së Peshturës

- **Punëtori edukative**: mësime mbi biodiversitetin e Kurveleshit, kulturën dhe historinë e zonës, si dhe punë praktike në ferma lokale.

- **Aktivitete sportive dhe kulturore**: lojëra ekipore, mbrëmje muzikore dhe prezantime nga banorët.

- **Projekte komunitare**: nxënësit ndihmojnë në pastrimin e shtigjeve dhe rigjallërimin e monumenteve lokale duke forcuar lidhjet komunitare.

## PJESA B

# 6. PLANI I BIZNESIT

Ky seksion paraqet analizën e plotë financiare të Kampit Veror në Progonat dhe shërben për të vlerësuar fizibilitetin ekonomik, vetë-qëndrueshmërinë e aktivitetit dhe përputhshmërinë me natyrën jo-fitimprurëse të organizatës zbatuese. Qëllimi kryesor i modelit financiar nuk është gjenerimi i fitimit, por mbulimi i plotë i kostove operative, krijimi i një rezerve minimale sigurie dhe garantimi i vazhdimësisë së shërbimit edukativ dhe komunitar në afatmesëm dhe afatgjatë.

Modeli financiar është ndërtuar mbi bazën e një sezoni veror tre-mujor (qershor–gusht), me 10 turne njëjavore dhe grupe mesatare prej 15 nxënësish për turn. Të gjitha përllogaritjet janë bërë në euro dhe bazohen në çmimet aktuale të tregut për ushqim, paga, transport dhe shërbime ndihmëse në zonën e Tepelenës dhe Kurveleshit.

Tarifa e pjesëmarrjes është përcaktuar në nivelin 400 euro për nxënës për një turn njëjavor. Kjo tarifë është gjithëpërfshirëse dhe mbulon akomodimin në godinë, ushqimin me tre vakte në ditë, programin edukativ dhe sportiv, shërbimet e guidave lokale, transportin lokal gjatë ekskursioneve si dhe të gjitha materialet bazë të aktiviteteve. Vendosja e kësaj tarife është bërë duke marrë në konsideratë aftësinë paguese të familjeve, çmimet e kampeve të ngjashme në Shqipëri dhe objektivin social të projektit.

## 6.1 Supozimet e këtij modeli

| Parametri | Vlera |
|---|---|
| Kohëzgjatja e sezonit | Qershor -Gusht (3 muaj) |
| Numri i turneve | 10 turne |
| Nxënës për grup | 15-20 |
| Kapaciteti total sezonal | 150 – 200 nxënës |
| Tarifa për nxënës | 400 EUR /javë |

**Tabela 2. Parametrat kryesorë të funksionimit sezonal**

Në kushtet e mbushjes së plotë të kapacitetit, modeli parashikon një numër total prej 150 nxënësish gjatë sezonit. Në këtë skenar, të ardhurat sezonale arrijnë nivelin maksimal të planifikuar.

## 6.2 Të ardhurat sezonale

Të ardhurat kryesore burojnë nga tarifat e pjesëmarrjes së nxënësve në kamp. Llogaritja bazohet në numrin e grupeve, madhësinë mesatare të grupit dhe tarifën për nxënës.

| **Përshkrimi** | **Formula** | **Vlera (EUR)** |
|---|---|---|
| Nxënës gjithsej | 15 x 10 grupe | 150 |
| Tarifa për nxënës | - | 400 |
| Të ardhura totale sezonale | 150 * 400 | 60.000 |

**Tabela 3. Të ardhurat nga aktiviteti i kampit**

## 6.3 Struktura e kostove operative (OPEX)

Struktura e kostove operative përfshin të gjitha shpenzimet e domosdoshme për funksionimin normal të kampit gjatë sezonit veror. Zëri kryesor i kostove lidhet me pagat e stafit dhe furnizimin ushqimor, të ndjekura nga shpenzimet për aktivitete, transport dhe shërbime mbështetëse.

| **Zëri i shpenzimit** | **Vlera (EUR)** |
|---|---|
| Kosto ushqimore (3 vakte/ditë) | 17,500 |
| Paga e stafit (3 muaj) | 24,000 |
| Shpenzime utilitare (energji, ujë, internet) | 2,000 |
| Eskursione dhe aktivitete | 4,500 |
| Trajnime dhe Certifikime | 2,500 |
| Transporti lokal | 2,500 |
| Ëeb dhe marketing | 2,000 |
| Shpenzime të tjera | 1,500 |
| Total OPEX | 56,500 |

**Tabela 4. Shpenzimet operative sezonale (OPEX)**

## 6.4 Rezultati financiar – Skenari bazë (100% mbushje)

Në skenarin optimal me mbushje të plotë të kapacitetit, krahasimi midis të ardhurave dhe kostove operative jep rezultatin financiar sezonal.

| Përshkrimi | Vlera (EUR) |
|---|---|
| Të ardhura totale | 60,000 |
| Shpenzime Operative (OPEX) | 56,500 |
| Tepricë operative | +3,500 |

**Tabela 5. rezultati financiar sezonal**

Kjo tepricë nuk konsiderohet fitim, por shërben si rezervë sigurie për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara, mirëmbajtjen periodike të godinës dhe garantimin e stabilitetit financiar të aktivitetit në sezonet pasuese.

## 6.5 Analiza e ndjeshmërisë. Skenari realist (60% mbushje)

Për të vlerësuar rrezikun financiar, është analizuar edhe skenari realist me normë mbushjeje 60 për qind.

| Parametri | Vlera |
|---|---|
| Nxënës gjithsej | 90 |
| Tarifa për nxënës | 400 € |
| Të ardhura reale | 36,000 € |

Tabela 6. Skenari realist i pjesëmarrjes

| Përshkrimi | Vlera (€) |
|---|---|
| Të ardhura reale | 36,000 |
| Shpenzime operative | 56,500 |
| Rezultat | –20,500 |

Tabela 7. – Rezultati financiar në skenarin 60%

Ky rezultat tregon se projekti kërkon një normë të lartë mbushjeje ose masa shtesë optimizimi për të ruajtur vetë-qëndrueshmërinë financiare.

6.6 Analiza e pikws sw barazimit (break-even)

Pika e barazimit përllogaritet duke pjesëtuar kostot operative me tarifën për nxënës.

| Përshkrimi | Vlera |
|---|---|
| Kosto totale operative | 56,500 |
| Tarifa për nxënës | 400 |
| Nxënës minimal për barazim | 141 |
| Norma e nevojshme e mbushjes | Rreth 94% |

Tabela 8. Pika e barazimit

Kjo analizë tregon se projekti është financiarisht i qëndrueshëm vetëm me një nivel të lartë pjesëmarrjeje, çka justifikon rëndësinë e marketingut dhe marrëveshjeve paraprake me shkolla dhe institucione.

## 6.7 Politika financiare dhe natyra jo-fitimprurëse

Në përputhje me statusin jo-fitimprurës të organizatës zbatuese, çdo tepricë e krijuar nga aktiviteti do të riinvestohet në mirëmbajtjen e objektit, përmirësimin e kushteve të akomodimit, zhvillimin e programeve edukative dhe mbështetjen

e grupeve në nevojë. Nuk parashikohet shpërndarje fitimi dhe i gjithë aktiviteti zhvillohet në funksion të misionit edukativ dhe komunitar.

### 6.8 Përfundim financiar

Analiza tregon se Kampi Veror në Progonat është ekonomikisht i realizueshëm në kushtet e një menaxhimi të kujdesshëm dhe një norme të lartë mbushjeje. Modeli financiar garanton mbulimin e kostove, krijon përfitime të drejtpërdrejta për komunitetin lokal dhe përputhet me politikat e zhvillimit vendor dhe me natyrën jo-fitimprurëse të projektit.

## 7. PËRFITIMET PËR BASHKINË DHE KOMUNITETIN

**Të ardhurat nga qiraja dhe taksat**: Bashkia do të përfitojë nga dhënia me qira e objektit dhe nga taksat turistike të mbledhura. Ligji për vetëqeverisjen vendore parashikon që bashkitë mund të gjenerojnë të ardhura përmes qiradhënies së pasurive.

**Punësimi i banorëve lokalë**: Stafi i kampit (mësues, guida, punonjës kuzhine, mirëmbajtës) rekrutohet në Kurvelesh, duke krijuar punësim sezonal dhe duke ndihmuar ekonominë familjare.

**Zhvillimi i turizmit**: Promovimi i atraksioneve natyrore si Kanioni i Nivicës dhe ujëvarat krijon rrjedhë të re turistësh që shfrytëzojnë edhe shërbimet e tjera vendore (fjetje, bare, artizanat).

**Arsimim dhe ndërgjegjësim**: Programet edukative u japin nxënësve njohuri mbi historinë, kulturën dhe mjedisin, ndërsa komuniteti përfiton nga bashkëpunimi dhe shkëmbimi i ideve.

## 8. PËRFUNDIM

Analiza e realizuar në këtë studim fizibiliteti tregon se projekti për krijimin e Kampit Veror në Progonat përfaqëson një nismë të realizueshme nga pikëpamja teknike, infrastrukturore dhe organizative, me potencial të rëndësishëm zhvillimor për Bashkinë Tepelenë dhe komunitetin e Kurveleshit.

Nga pikëpamja infrastrukturore, godina ekzistuese e shkollës "Asim Zeneli" ofron kushte të përshtatshme për rehabilitim me një kosto relativisht të moderuar. Investimi prej rreth 43 000 euro është ekonomikisht i justifikuar dhe krijon vlera afatgjata përmes rikthimit në

funksion të një pasurie publike të amortizuar dhe rritjes së kapaciteteve turistike dhe edukative të zonës.

Nga pikëpamja operacionale, modeli i funksionimit me turne njëjavore, grupe të vogla dhe staf lokal garanton fleksibilitet, cilësi shërbimi dhe kontroll të kostove. Programet edukative dhe aktivitetet në natyrë e pozicionojnë kampin si një qendër të specializuar për turizëm arsimor dhe edukim mjedisor, duke e diferencuar nga format tradicionale të akomodimit turistik.

Gjetjet kryesore të analizës financiare tregojnë se projekti është i vetë-qëndrueshëm në kushtet e një norme të lartë mbushjeje. Me mbushje të plotë të kapacitetit, aktiviteti gjeneron të ardhura prej 60 000 euro dhe mbulon shpenzimet operative prej 56 500 euro, duke krijuar një rezervë minimale sigurie prej 3 500 euro.

Në skenarin realist me 60% mbushje, projekti rezulton me deficit prej rreth 20 500 euro, çka tregon ndjeshmërinë e lartë ndaj nivelit të pjesëmarrjes. Analiza e pikës së barazimit konfirmon se për të mbuluar plotësisht kostot nevojiten të paktën 141 nxënës në sezon, ose rreth 94% e kapacitetit.

Nga pikëpamja sociale dhe ekonomike, projekti krijon përfitime të drejtpërdrejta për komunitetin lokal përmes punësimit sezonal, rritjes së kërkesës për produkte vendore dhe përfshirjes së guidave, edukatorëve dhe artizanëve lokalë. Kjo qasje forcon ndjenjën e pronësisë komunitare dhe kontribuon në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës.

Nga pikëpamja institucionale, projekti është në përputhje me kuadrin ligjor për vetëqeverisjen vendore dhe politikat kombëtare për zhvillimin e turizmit, arsimit dhe zonave malore. Bashkia Tepelenë përfiton nga mirëmbajtja e pronës publike, rritja e aktivitetit turistik dhe krijimi i një modeli të ri bashkëpunimi publik-komunitar.

Në përfundim, gjetjet e studimit konfirmojnë se Kampi Veror në Progonat është një investim me fizibilitet të lartë teknik dhe ndikim të rëndësishëm social e ekonomik, por që kërkon një strategji të fortë promovimi, marrëveshje paraprake me institucione arsimore dhe një strukturë menaxhimi profesionale për të garantuar mbushje të lartë, siguri financiare dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

## 9. REFERENCA DHE BURIME

Ky studim është përgatitur duke u mbështetur në kuadrin ligjor kombëtar, dokumente strategjike të zhvillimit dhe burime statistikore e teknike që lidhen me turizmin, arsimin dhe vetëqeverisjen vendore. Referencat kryesore përfshijnë:


a. Kuvendi i Shqipërisë (2015). **Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"**.
b. Kuvendi i Shqipërisë (2001, i ndryshuar). **Ligji nr. 8788 "Për Organizatat Jofitimprurëse.**
c. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (2018–2022). **Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm**.
d. Këshilli i Ministrave (2015). **Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Rural dhe Bujqësinë**.
e. INSTAT (2023–2024). **Statistika mbi turizmin dhe lëvizjen e vizitorëve në Shqipëri**.
f. Bashkia Tepelenë (2023). **Strategjia e Zhvillimit Vendor dhe Plani i Përgjithshëm Vendor**.
g. Ministria e Arsimit dhe Sportit (2019). **Udhëzimi për përdorimin e objekteve arsimore jashtë orarit mësimor për aktivitete sociale dhe edukative**.
h. World Tourism Organization (UNWTO) (2019). **Guidelines for Sustainable Tourism and Community-Based Tourism Development**.
i. European Commission (2020). **Best Practices in Youth Camps and Educational Tourism Facilities**.
j. International Hostel Federation (IYHF). **Hostel Standards and Accommodation Guidelines**..

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA TEPELENË**
**KRYETARI**

Nr. 385 prot.

Tepelenë, më 19.02.2026

# URDHËR

**Nr. 30 datë 19.02.2026**

## PËR
## VERIFIKIMIN E GJENDJES FAKTIKE TË OBJEKTIT PUBLIK "SHKOLLA 9-VJEÇARE ASIM ZENELI", FSHATI PROGONAT, BASHKIA TEPELENË

Bazuar në: Nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja "b" dhe pika 1/1.2, nenin 27, pika 5, nenin 36, nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërorë që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës"; Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 995, datë 10.12.2010, "Për inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme shtetërore dhe publike" i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për inventarizimin dhe menaxhimin e aktiveve të njësive publike", i ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Nevojës për përgatitjen e relacioni teknik, inventarial si pjesë e dosjes shoqëruese për propozimin e Kryetarit të Bashkisë drejtuar Këshillit Bashkiak Tepelenë, mbi dhënien në përdorim të një pjese të objektit publik për organizimin e kampit veror edukativ nga Qendra ACEG,

## U R DH Ë R O J:

**I.** Të ngrihet Grupi i Punës ndërsektorial për verifikimin në terren të gjendjes faktike, teknike, funksionale dhe inventariale të objektit publik "Shkolla 9-vjeçare Asim Zeneli", fshati Progonat, Njësia Administrative Kurvelesh.

Grupi i punës përbëhet nga:

1. Albion Tahmazi – Kryetar
2. Aleksandër Toti – Anëtar

3. Arta Shaha – Anëtar
4. Adi Vela – Anëtar
5. Luan Meta – Anëtar

**II.** Grupi i punës ka për detyrë:

a) Të kryejë inspektimin fizik dhe teknik të objektit në terren;
b) Të konstatojë gjendjen strukturore, funksionale, teknike dhe përdorimin aktual të ambienteve;
c) Të identifikojë dhe përshkruajë pjesët e objektit që mund të jepen në përdorim, duke përcaktuar sipërfaqet dhe kufijtë funksionalë;
d) Të verifikojë statusin juridik dhe inventarial të pasurisë në regjistrat e pasurive publike dhe dokumentacionin e transferimit të pronësisë;
e) Të hartojë Relacionin Teknik, Inventarial dhe Juridik, i cili do të shërbejë si dokument shoqërues për propozimin e Kryetarit të Bashkisë drejtuar Këshillit Bashkiak Tepelenë.
f) Relacioni teknik, i verifikimit në terren dhe dokumentacioni shoqërues të paraqiten brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e këtij urdhri pranë Kryetarit të Bashkisë Tepelenë.

**III.** Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I BASHKISË**

**Gramos Sako**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA TEPELENË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA TEPELENË**

Nr. 395/1 prot.

Tepelenë, më 20.02.2026

# RELACION TEKNIK
# PËR
# VERIFIKIMIN E GJENDJES FAKTIKE TË OBJEKTIT PUBLIK "SHKOLLA 9-VJEÇARE ASIM ZENELI", FSHATI PROGONAT, BASHKIA TEPELENË

Ky relacion teknik u përgatit nga Bashkia Tepelenë me qëllim verifikimin në terren të gjendjes faktike të objektit publik "Shkolla 9-vjeçare Asim Zeneli", në fshatin Progonat, Njësia Administrative Kurvelesh, Zona Kadastrale 3057, nr. Pasurie 682 dhe sipërfaqe 507 $m^2$. Relacioni shërben si dokument inventarial dhe teknik dhe do të përdoret si pjesë përbërëse e dokumentacionit shoqërues për propozimin e Kryetarit të Bashkisë drejtuar Këshillit Bashkiak Tepelenë, mbi dhënien në përdorim të një pjese të këtij objekti për organizimin e kampit veror edukativ nga Qendra ACEG.

Objekti i verifikuar është godina e shkollës 9-vjeçare "Asim Zeneli", e ndodhur në fshatin Progonat, Njësia Administrative Kurvelesh, Bashkia Tepelenë. Objekti është pronë publike e Bashkisë Tepelenë, e transferuar në pronësi/përdorim sipas akteve përkatëse ligjore dhe nënligjore. Godina është ndërtim ekzistues, me disa kate funksionale dhe oborr përreth, i destinuar për përdorim arsimor.



*Figure 1. Foto e situatës ekzistuese Shkolla ''Asim Zeneli''*

Verifikimi i situatës faktike është kryer përmes inspektimit në terren nga Grupi i Punës të administratës së Bashkisë Tepelenë. Gjatë inspektimit janë evidentuar gjendja fizike e objektit, funksioni aktual i ambienteve, shkalla e përdorimit të tyre, si dhe gjendja e infrastrukturës bazë. Verifikimi është kryer pa ndërhyrje fizike në objekt dhe pa ndryshuar gjendjen ekzistuese të tij.

Nga verifikimi në terren rezulton se godina e shkollës është pjesërisht funksionale për procesin mësimor, ndërsa një pjesë e ambienteve rezultojnë të papërdorshme ose të nënshfrytëzuara.

Ambientet që aktualisht përdoren për funksione arsimore janë të ndara qartë nga ambientet e tjera dhe nuk preken nga kërkesa për dhënie në përdorim.
Pjesa e objektit që rezulton e papërdorshme për procesin mësimor përfshin: kati I dhe kati III dhe gjysma e kati-it II, dhe hapësira ndihmëse, të cilat janë të zbrazëta dhe nuk përdoren.

Këto ambiente paraqesin amortizim të zakonshëm nga përdorimi dhe mosmirëmbajtja periodike, por nuk paraqesin rrezik strukturor të dukshëm. Muret, dyshemetë dhe tavani janë në gjendje të qëndrueshme, ndërsa dritaret, dyert dhe instalimet kanë nevojë për përmirësime funksionale.



*Figure 2. Situata e një klase të papërdorur, kat III*

Oborri i shkollës dhe hapësirat përreth objektit janë të aksesueshme dhe nuk janë të zëna nga aktivitete të tjera të përhershme. Këto hapësira përdoren në mënyrë sporadike dhe rezultojnë të përshtatshme për aktivitete të kontrolluara sezonalë.

**Foto 3–4 Korridore të brendshme (kat i papërdorshëm)**

Fotot paraqesin korridore të brendshme me mure të amortizuara, dysheme me dëmtime sipërfaqësore dhe mobilje shkollore të grumbulluara. Ambientet janë të papërdorshme aktualisht dhe nuk shërbejnë për qarkullim të rregullt të nxënësve.



*Figure 3. Koridori i brendshëm kat 3*

**Foto 4: Ish-klasa me mobilim të vjetër shkollor**

Fotot dokumentojnë ambiente ku ndodhen banka dhe karrige shkollore të vjetra, të vendosura në mënyrë të çrregullt, duke dëshmuar se këto klasa nuk janë funksionale për proces mësimor dhe janë jashtë përdorimit aktiv.



*Figure 4. Klasa me mobilim të vjetër*

**Foto 5: Ambient i rehabilituar kat përdhes (hapësirë e lirë)**

Fotoja paraqet një ambient me dysheme të shtruar dhe strukturë të qëndrueshme, aktualisht i papërdorshëm, i cili mund të shfrytëzohet për funksione ndihmëse pas përshtatjes.



*Figure 5. Kati I (ish-palestra)*

**Foto 6: Shkallë dhe lidhje vertikale**

Fotoja dokumenton shkallët e brendshme të godinës, të cilat janë funksionale, por paraqesin nevojë për mirëmbajtje dhe pajisje sigurie.



*Figure 6. Shkallët drejt kat-it 3*

Objekti është i lidhur me rrjetin e energjisë elektrike dhe furnizimin me ujë. Instalimet elektrike dhe hidrike janë në gjendje të amortizuar dhe kërkojnë ndërhyrje për përmirësim dhe përshtatje me standardet e përdorimit sezonal. Nuk janë konstatuar instalime të posaçme sigurie ose sisteme zjarrfikëse funksionale në ambientet e papërdorshme, çka do të kërkojë ndërhyrje përpara çdo përdorimi të ri.

Bazuar në gjendjen faktike të konstatuar, ambientet e papërdorshme të objektit janë të ndara funksionalisht nga ambientet arsimore aktive dhe mund të përdoren në mënyrë sezonale, pa cenuar zhvillimin e procesit mësimor. Çdo përdorim i ardhshëm i këtyre ambienteve do të kërkojë respektimin e kushteve të sigurisë, higjienës dhe mirëmbajtjes, si dhe kryerjen e ndërhyrjeve rehabilituese nga subjekti përdorues.

Në përfundim të verifikimit teknik, konstatohet se objekti publik "Shkolla 9-vjeçare Asim Zeneli", në pjesët e papërdorshme të tij, paraqet kushte të përshtatshme për përdorim sezonal, me kusht që të kryhen ndërhyrje rehabilituese dhe të respektohen standardet e sigurisë dhe mirëmbajtjes. Ky relacion teknik rekomandohet të përdoret si dokument shoqërues dhe inventarial në procedurën e dhënies në përdorim të objektit.

*(fotografi të ambentieve dhe planimetri funksionale, Aneksi Teknik bashkëlidhur)*

**GRUPI I PUNËS:**

1. Albion Tahmazi (Kryetar) ____________.
2. Aleksandër Toti (Anëtar) ____________.
3. Arta Shaha (Anëtar) ____________.
4. Adi Vela (Anëtar) ____________.
5. Luan Meta (Anëtar) ____________.

**ANEKS TEKNIK:**

**Fotografi të gjendjes ekzistuese:**







**Parametra:** Klasa 6×5 m (30 m²) | Korridor 3 m | Dritare: 3 / klasë | Derë: 1 / klasë | Shkalla: 1:100

**A) Përmbledhje sipërfaqesh** (neto, indikative)

| Niveli | Konfigurimi | Total neto (m²) |
|---|---|---|
| KATI 0 (Përdhes) | Vetëm krah vertikal  Palestër | 234.0 |
| KATI 1 | Formë L (2 krahë)  Klasa | 468.0 |
| KATI 2 | Vetëm krah vertikal  Klasa | 234.0 |

**TOTALI NETO** (të tre katet)**: 936 m²**

**B)** Detaj sipërfaqesh sipas funksioneve

| Niveli | Hapësira/Funksioni | Sipërfaqe (m²) |
| --- | --- | --- |
| KATI 0 (Përdhes) | Palestër sallë e vetme (13×12 m) | 156.0 |
| KATI 0 (Përdhes) | Dhomë zhveshje 1 (5×6 m) | 30.0 |
| KATI 0 (Përdhes) | Tualet (3×6 m) | 18.0 |
| KATI 0 (Përdhes) | Dhomë zhveshje 2 (5×6 m) | 30.0 |
| KATI 1 | Klasa (12 × 30 m²) | 360.0 |
| KATI 1 | Korridorë (2 × 3×18 m) | 108.0 |
| KATI 2 | Klasa (6 × 30 m²) | 180.0 |
| KATI 2 | Korridor (3×18 m) | 54.0 |

**Shënim:** Llogaritjet janë modulare/neto dhe kërkojnë rilevim në terren për miratim përfundimtar. Dritaret/dyert janë të paraqitura skematikisht (3 dritare + 1 derë për klasë).

**GENTPLAN TEKNIK - KATI 0** (PËRDHES)

Palestër + 2 dhoma zhveshje + tualet



Palestër + 2 dhoma zhveshje + tualet




1:100 Dritare: 3/klasë - Derë 1/klasë (sistematike)




**GRUPI I PUNËS:**

1. Albion Tahmazi (Kryetar)
2. Aleksandër Toti (Anëtar)
3. Arta Shaha (Anëtar)
4. Adi Vela (Anëtar)
5. Luan Meta (Anëtar)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA TEPELENË**
**KABINETI I KRYETARIT**

Nr.367 prot.

Tepelenë, më 17.02.2026

**Lënda:** Kërkesë për informacion dhe dhënie opinioni lidhur me përdorimin sezonal të një pjese të ambienteve të shkollës 9-vjeçare "Asim Zeneli", fshati Progonat, për organizimin e një kampi veror edukativ.

**ZYRËS VENDORE ARSIMORE TEPELENË**
**Rr. Batalioni ''Baba Abaz'', Tepelenë**

Bashkia Tepelenë, në ushtrim të kompetencave të saj sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi për administrimin e pasurive publike, ju bën me dije se pranë Bashkisë është paraqitur një kërkesë nga Qendra ''ACEG'', për përdorimin sezonal të një pjese të objektit publik "Shkolla 9-vjeçare Asim Zeneli", fshati Progonat, Njësia Administrative Kurvelesh, për organizimin e një kampi veror edukativ gjatë periudhës së pushimeve verore.

Në kuadër të shqyrtimit të kësaj kërkese, Bashkia Tepelenë ka kryer verifikimin teknik të gjendjes faktike të objektit dhe rezulton se godina përdoret aktualisht pjesërisht për realizimin e procesit mësimor, ndërsa disa ambiente janë të papërdorshme dhe të amortizuara. Ambientet e propozuara për përdorim sezonal janë të ndara funksionalisht nga hapësirat ku aktualisht realizohet mësimi dhe nuk parashikohet ndërhyrje, cënim apo kufizim i procesit arsimor.

Duke qenë se objekti në fjalë është institucion arsimor publik dhe në respektim të legjislacionit në fuqi për arsimin parauniversitar, Bashkia Tepelenë kërkon nga Zyra Vendore Arsimore opinionin tuaj zyrtar lidhur me:

1. Identifikimin e ambienteve/klasave ku aktualisht realizohet procesi mësimor në institucionin arsimor ''Shkolla 9-vjeçare Asim Zeneli''.

2. Vlerësimin nëse përdorimi sezonal i ambienteve të papërdorshme gjatë periudhës së pushimeve verore cënon apo jo funksionin arsimor të shkollës, në përputhje me Ligjin nr. 69/2012 i ndryshuar, me Ligjin 56/2015, Ligjin 48/2018 dhe aktet nënligjore përkatëse.

3. Çdo rekomandim, kusht apo masë që Zyra Arsimore Rajonale vlerëson të nevojshëm për t'u respektuar në rast të dhënies në përdorim të këtyre ambienteve për qëllime

kampi veror edukativ, përfshirë aspektet e sigurisë, higjienës, mbrojtjes së nxënësve dhe ruajtjes së funksionit publik të institucionit arsimor.

Opinioni juaj do të shërbejë si pjesë e dokumentacionit shoqërues për vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak Tepelenë, si dhe për garantimin e respektimit të plotë të funksionit arsimor dhe interesit publik të institucionit.

Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të përgjigjes suaj.

Me respekt,

Konceptoi: A. Toti
Konfirmoi: A. Toti

**KRYETARI I BASHKISË**

**Gramoz Sako**

Nr-385/2
23.02.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E ARSIMIT**
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**
**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER**
**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TEPELENË-MEMALIAJ**

**Nr** 152 **prot.** Tepelenë 23.02.2026

**Drejtuar:** Bashkisë Tepelenë

**Lënda:** Kthim përgjigjeje

Në përgjigje të kërkesës suaj, shprehur në shkresën me nr. 367 prot, datë 17.02.2026 "Kërkesë për informacion dhe dhënie opinioni lidhur me përdorimin sezonal të një pjese të ambienteve të shkollës 9-vjeçare ''Asim Zeneli'', fshati Progonat, për organizimin e një kampi veror edukativ", protokolluar prej nesh me nr. 149 prot, datë 20.02.2026, ju përcjellim dakordësinë tonë për shfrytëzimin e mjediseve të katit të dytë, ku aktualisht nuk zhvillohet mësim apo ndonjë veprimtari tjetër shkollore; për më tepër, këto mjedise po amortizohen me shpejtësi, duke rrezikuar edhe mjdiset mësimore të katit të parë.
Sikurse përmendni edhe në shkresën tuaj,inspektimi i kryer prej institucionit të bashkisë Tepelenë, identifikohen lehtë mjediset funksionale në katin I dhe ato të papërdorshme në katin II, përdorimi sezonal i së cilave, pa cënuar procesin mësimor, do t'i shtonte funksionalitetin, komoditetin dhe sigurinë godinës së shkollës 9-vjeçare të arsimit bazë "Asim Zeneli", në fshatin Progonat.
Struktura e brendshme e godinës dhe hapësirat e bollshme në mjedisin përreth, krijojnë kushte për një hyrje të pavarur për klasat e katit të dytë, si dhe mundësojnë përmirësime të qëndrueshme të oborrit të shkollës.

Duke ju falenderuar, ju përcjellim gatishmërinë për vijim e bashkëpunimit.

**Drejtori**
**Shkëlqim IMERA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
TEPELENË MEMALIAJ FIER
MINISTRIA E ARSIMIT

Adresa:Rruga ''Batalioni Baba Abas'', Tepelenë e-mail: zvatepelene@arsimi.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I BASHKISË**
**TEPELENË**

Nr. ...580/1...prot. Tepelenë, më 24.03...2026

P/VENDIM

Nr.__________datë__________2026

**“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS NË BASHKINË TEPELENË”**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, neni 54 ,ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025 “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë,

VENDOSI

1. Të miratojë Programin e Transparencës për Bashkinë Tepelenë, pjesë përbërse bashkëlidhur këtij projekt-vendimi.

2. Të ngarkojë të gjitha strukturat administrative të Bashkisë Tepelenë për zbatimin e Programit të Transparencës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Programi i Transparencës të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Tepelenë dhe të përditësohet në mënyrë periodike, sipas kërkesave ligjore.

4. Të ngarkohet Koordinatori për të Drejtën e Informimit për ndjekjen, monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e këtij programi.

5 Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve ligjore.

**Jurist** **KRYETAR**

**Julinda Karteri** **Arben Gumeni**

*Adresa "Sheshi Lord BAJRON", WEB: www.tepelena.gov.al, email info@tepelena.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA TEPELENË**
**DREJTORIA LIGJORE**
**KOORDINATORI I INFORMIMIT PUBLIK**

SEKRETARIA BASHKIA TEPELENË

Nr ...580.......Prot

Tepelenë më 24.03...2026

RELACION

PËR PROJEKT VENDIMIN Nr. _________ datë _______

## PËR MIRATIMIN E "PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS" NË BASHKINË TEPELENË

Ky relacion ka për qëllim të paraqesë arsyetimin dhe bazën ligjore për miratimin e Programit të Transparencës në Bashkinë Tepelenë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, si dhe të theksojë rëndësinë që ky program ka për garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimin e marrëdhënies ndërmjet administratës vendore dhe qytetarëve.

Baza Ligjore:

• Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, që garanton të drejtën për informim;

• Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar;

• Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;

• Urdhri nr. 281, datë 30.12.2025, i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për NJVV" ;

• Aktet nënligjore dhe udhëzimet përkatëse në fushën e transparencës dhe qeverisjes së mirë.

**ARGUMENTIMI I PROJKET VENDIMIT:**

Rëndësia e Programit Të Transparencës

Zbatimi i Programit të Transparencës përbën një instrument thelbësor për garantimin e qeverisjes së hapur dhe për forcimin e besimit të qytetarëve ndaj institucionit të Bashkisë Tepelenë.

Programi synon të:

• sigurojë publikimin sistematik dhe në kohë të informacionit publik;
• rrisë aksesin e qytetarëve në vendimmarrje;
• përmirësojë standardet e llogaridhënies institucionale;
• forcojë integritetin dhe transparencën në administratën vendore;
• kontribuojë në përmbushjen e standardeve të integrimit europian në nivel vendor.

Vështrimi i situatës aktuale

Bashkia Tepelenë, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve dhe rritjes së transparencës institucionale, ka ndërmarrë hapa për publikimin e informacionit në faqen zyrtare dhe për komunikimin me qytetarët.

Megjithatë, evidentohet nevoja për:

• standardizimin e publikimit të informacionit sipas një strukture të unifikuar;
• përditësimin periodik të të dhënave në përputhje me kërkesat ligjore;
• forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit;
• rritjen e ndërveprimit me qytetarët dhe grupet e interesit.

Vizioni dhe Objektivat Kryesore

Vizioni

Një administratë vendore transparente, e përgjegjshme dhe e hapur ndaj qytetarëve, që garanton akses të plotë në informacion dhe pjesëmarrje aktive në vendimmarrje.

Objektivat kryesore:

• Transparenca institucionale: publikim i plotë i strukturës, funksioneve dhe veprimtarisë së bashkisë;
• Llogaridhënia financiare: publikim i buxhetit, shpenzimeve dhe proceseve të prokurimit;
• Aksesi në informacion: lehtësim i procedurave për kërkesat për informim;
• Përmirësimi i shërbimeve: transparencë mbi shërbimet dhe standardet e tyre;
• Pjesëmarrja qytetare: rritje e konsultimeve publike dhe përfshirjes së komunitetit.

Përmbajtja e Programit të Transparencës

Programi i Transparencës i Bashkisë Tepelenë strukturohet në disa fusha kryesore:

• Organizimi dhe funksionimi i bashkisë;
• Transparenca ekonomiko-financiare;
• Procedurat për të drejtën e informimit;
• Shërbimet publike dhe administrative;
• Legjislacioni dhe aktet vendore;
• Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje;

• Informacioni mbi projektet dhe bashkëpunimet;
• Veprimtaria e Këshillit Bashkiak.

Ky program garanton publikimin e informacionit pa kërkesë, në mënyrë të strukturuar dhe të aksesueshme për qytetarët.

Mekanizmat e zbatimit dhe monitorimit

Zbatimi i Programit të Transparencës do të realizohet përmes:

• përcaktimit të strukturave përgjegjëse për çdo kategori informacioni;
• rolit të Koordinatorit për të drejtën e informimit;
• publikimit të informacionit në faqen zyrtare dhe në mjediset publike të bashkisë;
• monitorimit periodik të përmbushjes së detyrimeve ligjore;
• raportimit të rregullt mbi nivelin e transparencës.

VLERESIMI I LIGJSHMËRISË

Projekt-vendimi mbështetet në një bazë të plotë ligjore.
Ligji nr. 119/2014 përcakton detyrimin e autoriteteve publike për transparencë dhe publikim proaktiv të informacionit, ndërsa ligji nr. 139/2015 parashikon kompetencat e organeve të vetëqeverisjes vendore për miratimin e akteve në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tyre.Urdhri nr. 281, datë 30.12.2025, i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për NJVV.

PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PROJEKT-AKTIT

Projekt-vendimi "Për miratimin e Programit të Transparencës në Bashkinë Tepelenë" hartohet në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, si dhe nga Urdhri nr. 281, datë 30.12.2025, i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Qëllimi i këtij projekt-akti është miratimi i Programit të Transparencës, si një instrument i domosdoshëm për garantimin e të drejtës së publikut për informim dhe për rritjen e transparencës në veprimtarinë e Bashkisë Tepelenë.

Programi i Transparencës përcakton kategoritë e informacionit që duhet të publikohen në mënyrë proaktive në faqen zyrtare të bashkisë, mënyrën e publikimit të tyre, si dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse për përditësimin dhe mirëmbajtjen e këtij informacioni.

Nëpërmjet këtij projekt-vendimi synohet:

- rritja e aksesit të qytetarëve në informacion publik;
- përmirësimi i komunikimit ndërmjet administratës dhe komunitetit;
- forcimi i llogaridhënies dhe transparencës institucionale;

- përmbushja e detyrimeve ligjore në fushën e të drejtës së informimit.

Miratimi i këtij programi është një detyrim ligjor për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe duhet të realizohet brenda afatit të përcaktuar, jo më vonë se data 31 mars 2026.

Projekt-vendimi nuk ka ndikim financiar shtesë në buxhetin e bashkisë, pasi zbatimi i tij realizohet nga strukturat ekzistuese administrative.

Në përfundim, projekt-akti vlerësohet i domosdoshëm dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, ndaj propozohet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Tepelenë.

Koordinator i informimit
Ela Skënderaj

Lidhja nr. 1

# PROGRAMI I TRANSPARENCËS PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

## TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS

## BASHKIA TEPELENË

| Fusha 1 - Mbi organizimin dhe funksionimin e NJVV | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | Informacioni që bëhet publik pa kërkesë | Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni | Afati kohor për publikim | Organi miratues | Organi përgjegjës për publikimin |
| 1 | **Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet.** NJVV bën publike:<br>**1. Ndarjen administrativo-territoriale**<br>- Njësitë administrative dhe nën-ndarjet e tyre<br>**2. Të drejtat, përgjegjësitë dhe misionin e NJVV.**<br>**3. Funksionet**: Përfshin bërjen publike të:<br>- Funksioneve në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike<br>- Funksioneve në fushën e shërbimeve sociale<br>- Funksioneve në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese<br>- Funksioneve në fushën e mbrojtjes së mjedisit<br>- Funksioneve në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit<br>- Funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik vendor<br>- Funksioneve në fushën e sigurisë publike<br>- Funksionet dhe kompetencat e deleguara | Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë<br>Bashkia Tepelenë | Menjëherë | Sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2 | **Organi ekzekutiv** (Titullari i NJVV). Përfshin bërjen publike të:<br>- Procedurave të zgjedhjes<br>- Detyrat dhe kompetencat<br>- Të dhënat për arsimin, kualifikimet , paga e Titullarit dhe deklarimi i pasurisë<br>- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ<br>- Orari i pritjes së qytetarëve<br>- Adresa postare/ elektronike | Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë \| Bashkia Tepelenë | | | |
| 3 | **Administrata e NJVV.** Përfshin bërjen publike të:<br>- Strukturës organizative dhe numrin e punonjësve<br>- Rregullores së organizimit dhe funksionimit të administratës<br>- Strukturës së pagave<br>- Orarit të punës së NJVV, njësive administrative dhe njësive të varësisë<br>- Detyrave të administratës së njësive administrative<br>- Organizimit dhe funksionimit të njësive në varësi<br>- Njoftimeve mbi vende të lira pune dhe procedurat e rekrutimit<br>- Adresave postare dhe elektronike e zyrave të NJVV/njësive administrative/ njësive në varësi të NJVV<br>- Drejtuesit e zyrave, njësive administrative dhe njësive të varësisë | a) Në faqen zyrtare tëinternetit-menuja……..Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë | Titullari i NJVV | Sekretari i përgjithshëm i NJVV |
| 4 | **Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit**. Përfshin bërjen publike të:<br>- Kartës së Auditimit të Brendshëm<br>- Kodit të Etikës për audituesit e brendshëm<br>- Planit strategjik dhe vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm<br>- Çdo raporti të auditimit të brendshëm të ushtruar në NJVV<br>- Çdo raporti përfundimtar të kontrollit të jashtëm (KLSH) të ushtruar në NJVV | a) Në faqen zyrtare të internetit - menuja……..Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë \| Bashkia Tepelenë | Brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | - Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm | | | | |
| 5 | **Kërkesa, ankesa, sinjalizime dhe vërejtje që lidhen me** veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës. Përfshin bërjen publike të:<br>- Procedurave për të bërë kërkesë, ankesë, vërejtje dhe sinjalizime organeve të NJVV<br>- Rregullores së brendshme për procedurën e shqyrtimit, të hetimit administrativ, të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit<br>- Njësisë përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet<br>- Adresave postare/ elektronike për depozitimin e kërkesave, ankesave, sinjalizimeve apo vërejtjeve<br>- Afateve dhe mënyrave të kthimit të përgjigjeve në lidhje me kërkesat, ankesat apo vërejtjet | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.......Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë | Titullari i NJVV | Sekretari i përgjithshëm i NJVV |
| 6 | **Statistikat vendore**. Përfshin bërjen publike të:<br>- Kalendarit të publikimit të statistikave vendore<br>- Statistikave vendore me të dhënat kyçe të NJVV sipas fushave kryesore dhe të ndara sipas gjinisë<br>- Strukturës përgjegjëse në NJVV për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore | a)Në faqen zyrtare të internetit - menuja.......Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë pas miratimit | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

**Fusha 2 - Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare**

| **Nr.** | **Informacioni që bëhet publik pa kërkesë** | **Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni** | **Afati kohor për publikim** | **Organi miratues** | **Organi përgjegjës për publikimin** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor** | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.......Transparenca dhe Llogaridhënia | Në 10 ditëshin e parë të janarit | Këshilli i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Ekonomiko-Financiare \| Bashkia Tepelenë | | | |
| 2 | **Paketa fiskale (taksa dhe tarifa).** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Bazës së taksave dhe tarifave<br>2. Nivelit të taksave dhe tarifave<br>3. Përjashtimeve dhe lehtësimeve të subjekteve të caktuara<br>4. Afateve të pagesave<br>5. Gjobave dhe kamatëvonesave të aplikueshme | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare \| Bashkia Tepelenë | Brenda 15 ditëve nga miratimi | Këshilli i NJVV | Titullari i NJVV |
| 3 | **Plani Strategjik i Zhvillimit të NJVV.** Përmban:<br>1. Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm në një afat kohor jo më pak se 5 vite<br>2. Synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësi<br>3. Veprimet që duhen ndërmarrë duke parashikuar edhe kostot përkatëse<br>4. Burimet e financimit | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare \| Bashkia Tepelenë | 10 ditë nga data e miratimit | Këshilli i NJVV | Titullari i NJVV |
| 4 | **Programi buxhetor afatmesëm vendor.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Dokumentit të parë të programit buxhetor<br>2. Dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm<br>3. Dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm (përfshirë dokumentacionin shoqërues) dhe informacionit për dy vitet e fundit, vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese për çdo program (5 dokumentat përkatës) | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja…Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare \| | Dokumenti i parë brenda datës 5 korrik.<br>Dokumenti i rishikuar.<br>Dokumenti i plotë jo më vonë se data 31 dhjetor. | Këshilli i NJVV | Titullari i NJVV |

*Adresa "Sheshi Lord BAJRON", Web:www.tepelena.gov.al, email info@tepelena.gov.a*

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Bashkia Tepelenë | | | |
| 5 | **Buxheti.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Buxhetit vjetor së bashku me dokumentacionin shoqërues të tij (12 dokumentat përkatës)<br>2. Treguesve financiarë<br>3. Numrit të punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese<br>4. Regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik | a) Në faqen zyrtare të internetit-menuja……..(me link)Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare \| Bashkia Tepelenë | 15 ditë pas miratimit nga Këshilli i NJVV.<br><br>Regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit. | Këshilli i NJVV | Titullari i NJVV |
| 6 | **Zbatimi i buxhetit.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Raportit mujor (pas datës 30 prill të çdo viti buxhetor) të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve<br>(8 raporte) | a) Në faqen zyrtare të internetit-menuja……Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare \| Bashkia Tepelenë | Jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës | Titullari i NJVV<br><br>Informohet Këshilli i NJVV | Titullari i NJVV |
| 7 | **Monitorimi dhe mbikëqyrje** e buxhetit:<br>1. Raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit (jo më pak se tre raporte katër-mujore)<br>2. Raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit<br>2.1. Raportit të performancës vjetore<br>2.2. Pasqyrave financiare vjetore (dokumentacionin bazë dhe shoqërues)<br>3. Informacionit për zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punëve publike, mallrave, shërbimeve) | a) Në faqen zyrtare të internetit-menuja……Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare \| Bashkia Tepelenë | Raportet e monitorimit brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit.<br><br>Raporti vjetor i konsoliduar brenda muajit qershor të vitit | Raportet e monitorimit të zbatimit.<br>Titullari i NJVV<br>(Informohet Këshilli i NJVV-së)<br><br>Raporti vjetor i konsoliduar miratohet nga këshilli i NJVV.<br><br>Regjistri i realizimeve të prokurimit. Titullari i | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4. Regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit publik | | buxhetor pasardhës.<br><br>Regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit publik jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator dhe 10 janar të çdo viti. | NJVV (Informohet Këshilli i NJVV) | |
| 8 | **Vështirësitë financiare.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Planit për daljen nga situata e vështirë financiare | a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.......Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga shpallja. | Këshilli NJVV | Titullari i NJVV-së |
| 9 | **Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe aseteve** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Aseteve dhe pronave të ofruara për shitje ose dhënie me qira<br>2. Kritereve që duhet të plotësohen | a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja......Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare \| Bashkia Tepelenë | | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| 10 | **Donacionet.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Emrit të donatorit<br>2. Shumës së donacionit<br>3. Qëllimit e donacionit | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja...Transparenca dhe Llogaridhënia | Menjëherë | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Ekonomiko-Financiare \| Bashkia Tepelenë | | | |
| **Fusha 3- Për kërkesat për informim** | | | | | |
| **Nr.** | **Informacioni që bëhet publik pa kërkesë** | **Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni** | **Afati kohor për publikim** | **Organi miratues** | **Organi përgjegjës për publikimin** |
| 1 | **Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit (Emri, kontaktet dhe kompetencat)** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Emrit mbiemrit të Koordinatorit<br>2. Adresës postare/elektronike të tij<br>3. Orarit të punës<br>4. Detyrave dhe kompetencave të Koordinatorit<br>Adresës postare/elektronike për depozitimin e kërkesave për informim | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja……Kërkesa për informim \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë | Titullari i NJVV | Koordinatori për të drejtën e informimit |
| 2 | **Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankesës.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Procedurës që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion<br>2. Adresës postare/elektronike për dërgimin e kërkesës për informim<br>3. Modelit standard të një kërkese për informim<br>4. Afateve të marrjes së përgjigjes<br>5. Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankesë për mos dhënie informacioni<br>Adresës postare/elektronike për dërgimin e ankesës për mos dhënie informacioni | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja……Kërkesa për informim \| Bashkia Tepelenë | Brenda 48 orëve prej miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Koordinatori për të drejtën e informimit |
| 3 | **Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Të gjitha kërkesave për informim<br>2. Informacionet e dhënë në përgjigje të kërkesave për informim<br>Përditësimi i regjistrit | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja……Kërkesa për informim \| | Menjëherë | Titullari i NJVV | Koordinatori për të drejtën e informimit |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Bashkia Tepelenë | | | |
| 4 | **Tarifa për dhënien e informacionin (nëse ka)**<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1. Tarifave<br>2. Rregullave për mënyrën e kryerjes së pagesës Subjekteve që përfitojnë informacionin falas | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……Kërkesa për informim \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë | Titullari i NJVV | Koordinatori për të drejtën e informimit |

**Fusha 4 - Mbi shërbimet që ofron NJVV**

| Nr. | Informacioni që bëhet publik pa kërkesë | Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni | Afati kohor për publikim | Organi miratues | Organi përgjegjës për publikimin |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Shërbimet**<br>Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron NJVV sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015<br>1) Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike<br>2) Shërbimet në fushën e shërbimeve sociale<br>3) Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese<br>4) Shërbimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit<br>5) Shërbimet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit<br>6) Shërbimet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor<br>7) Shërbimet në fushën e sigurisë publike<br>8) Shërbimet në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara……………..<br>Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi:<br>✓ Instrumentin për administrimin e shërbimit<br>✓ Sistemin e administrimit të performancës së shërbimit bazuar mbi standardet<br>✓ Sistemin e treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……Shërbime që ofron Bashkia Tepelenë \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ✓ Strukturën përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor | | | |
| 2 | **Shërbimet administrative**<br>Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron NJVV sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015<br>1) Shërbimet administrative në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike<br>2) Shërbimet administrative në fushën e shërbimeve sociale<br>3) Shërbimet administrative në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese<br>4) Shërbimet administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit<br>5) Shërbimet administrative në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit<br>6) Shërbimet administrative t në fushën e zhvillimit ekonomik vendor<br>7) Shërbimet administrative në fushën e sigurisë publike<br>Shërbimet administrative në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara<br>Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi:<br>- Strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimit<br>- Adresën postare/elektronike të strukturave/ njësive/sporteleve që ofrojnë shërbime administrative<br>- Procedurat që duhen ndjekur për të përfituar shërbime administrative<br>- Oraret e punës së strukturave/njësive/sporteleve që ofrojnë shërbime administrative<br>- Tarifat për shërbimet administrative<br>- Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës<br>- Subjektet që përjashtohen nga tarifat | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.......Shërbime që ofron Bashkia Tepelenë \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3 | **Kontratat publike**. Përfshin bërjen publike të:<br>- Objektit të kontratës publike<br>- Numrit të referencës së procedurës/ kontratës<br>- Llojit të procedurës<br>- Termave dhe kushteve të kontratës<br>- Kohëzgjatjes së kontratës<br>- Vlerës së kontratës<br>- Dhënave të autoritetit kontraktor<br>- Dhënave të kontraktorit/ nënkontraktorit<br>- Treguesve për matjen e përmbushjes së kontratës<br>- Strukturave publike përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës<br>- Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankimim<br>- Raporteve të kontrollit, monitorimit dhe auditimit mbi zbatimin e kontratës | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja…Shërbime që ofron Bashkia Tepelenë \| Bashkia Tepelenë | Publikimi brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| 4 | **E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet**<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1. Procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet<br>2. Adresës postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja……Shërbime që ofron Bashkia Tepelenë \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga shpallja e miratimit | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| **Fusha 5 - Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore** | | | | | |
| **Nr.** | **Informacioni që bëhet publik pa kërkesë** | **Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni** | **Afati kohor për publikim** | **Organi miratues** | **Organi përgjegjës për publikimin** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore:**<br>1) I organizuar (jo i detyrueshëm) sipas fushave:<br>- Fusha e organizimit dhe funksionimit të NJVV<br>- Fusha e veprimtarisë ekonomiko-financiare<br>- Fusha e qeverisjes së mirë vendore (integriteti, etika, anti-korrupsioni, transparenca, llogaridhënia etj)<br>- Fusha e infrastrukturës dhe shërbimeve publike<br>- Fusha e shërbimeve sociale<br>- Fusha e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese<br>- Fusha e mbrojtjes së mjedisit<br>- Fusha e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit<br>- Fusha e zhvillimit ekonomik vendor<br>- Fusha e sigurisë publike<br>- Fusha e funksioneve dhe kompetencave të deleguara<br>2) Çdo fushë duhet të përmbajë:<br>- Aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse<br>- Dokumentet politike kombëtar përkatës<br>- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit të NJVV-së me karakter normativ<br>- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e Titullarit të NJVV-së me karakter normativ<br>- Dokumentet politike vendor | a)Në faqen zyrtare të internetit-menujaLegjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare.<br><br>Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit dhe Titullarit të NJVV-së brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Kuvendi i Shqipërisë<br><br>Këshilli i Ministrave<br><br>Ministri<br><br>Këshilli i NJVV<br><br>Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| **Fusha 6 - Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje** | | | | | |
| **Nr.** | **Informacioni që bëhet publik pa kërkesë** | **Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni** | **Afati kohor për publikim** | **Organi miratues** | **Organi përgjegjës për publikimin** |
| 1 | **Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Emër mbiemër të koordinatorit<br>2. Adresën postare/ elektronike të tij<br>3. Orarin e punës | a)Në faqen zyrtare të internetit-menujaPjesëmarrja e banoreve në vendimmarrje \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë pas miratimit të urdhrit të caktimit të Koordinatorit | Titullari i I NJVV | Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2 | **Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Akteve që do të konsultohen<br>2. Mënyrat e konsultimit<br>3. Afatet<br>Strukturat përgjegjëse | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja......Pjesëmarrja e banoreve në vendimmarrje \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit | Këshilli i NJVV<br><br>Titullari i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| 3 | **Dispozitat e brendshme rregullatorë për këshillimin me publikun.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Procedurave, afateve dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi<br>Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim | a)Në faqen zyrtare të internetit-menujaPjesëmarrja e banoreve në vendimmarrje \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit | Këshilli i NJVV<br><br>Titullari i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| 4 | **Akte për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Listës së akteve për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja......Pjesëmarrja e banoreve në vendimmarrje \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë | Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| 5 | **Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje**<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1. Projektaktit, relacionin shpjegues dhe dokumentave shoqërues të tij.<br>2. Arsyeve të nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë<br>3. Afatit, vendit dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre; | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja......Pjesëmarrja e banoreve në vendimmarrje \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë | Këshilli i NJVV<br><br>Titullari i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4. Adresën e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të i NJVV ose të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin;<br>5. Vendin dhe datën e organizimit të takimit publik në rastet kur NJVV vendos për organizimin e tij | | | | |
| 6 | **Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Adresën postare/ elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve<br>2. Afatin për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve<br>3. Mënyrën e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit të takimit publik për takimet publike<br>4. Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve<br>Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja......Pjesë marrja e banoreve në vendimmarrje \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë | Këshilli i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| 7 | **Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim** në lidhje me konsultimin publik.<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1. Subjektet ku mund të bëhet ankesa ( Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli i i NJVV, Titullari i i NJVV;)<br>2. Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës<br>3. Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun<br>4. Struktura përgjegjëse në nivel NJVV që regjistron dhe shqyrton ankesën | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja...Pjesëmarrja e banoreve në vendimmarrje \| Bashkia Tepelenë | Menjëherë | Këshilli i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| 8 | **Raporti vjetor për transparencën** në procesin e vendimmarrjes. Përfshin bërjen publike të:<br>1. Numrit të akteve të miratuara nga organet e i NJVV me konsultim publik gjatë një viti.<br>2. Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara; | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja...Pjesëmarrja e banoreve në vendimmarrje | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit | Këshilli i NJVV<br><br>Titullari i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 3. Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuara dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes.<br>4. Numrin e takimeve publike të organizuara | \| Bashkia Tepelenë | | | |
| 9 | **Iniciativa qytetare.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Mënyrës dhe formës së paraqitjes së iniciativës qytetare<br>2. Procedurave të shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare<br>3. Adresës postare/ elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare.<br>Mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mos miratimin e iniciativës qytetare | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja.......Pjesëmarrja e banoreve në vendimmarrje \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit | Këshilli i NJVV | Sekretari i Këshillit i NJVV<br><br>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik |
| **Fusha 7 - Informacion tjetër** | | | | | |
| **Nr.** | **Informacioni që bëhet publik pa kërkesë** | **Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni** | **Afati kohor për publikim** | **Organi miratues** | **Organi përgjegjës për publikimin** |
| 1 | **NJVV në proceset e integrimit evropian.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Të dhënave për projektet, nismat dhe veprimtarisë e NJVV në kuadrin e integrimit në BE | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja.......Informacion tjetër \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| 2 | **Bashkia dhe shoqëria civile.** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit<br>2. Të dhëna për OJF, përfaqësuesit e medias, biznesit<br>3. Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme<br>4. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja......Informacion tjetër \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |
| 3 | **Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të transparencës.** Përfshin bërjen publike të: | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja...Inform | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1. Raporte, studime dhe vlerësime mbi PT<br>2. Sisteme/metodollogji matje të PT | acion tjetër \| Bashkia Tepelenë | | | |
| 4 | **Strukturat komunitare**<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1. Dhënave për strukturat komunitare në fshat<br>2. Dhënave për strukturat komunitare në qytet<br>3. Detyrat, kompetencat dhe kompetencat e strukturave komunitare<br>4. Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja......Informacion tjetër \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Titullari i NJVV | Titullari i NJVV |

**Fusha 8 – Këshilli Bashkiak**

| Nr. | Informacioni që bëhet publik pa kërkesë | Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni | Afati kohor për publikim | Organi miratues | Organi përgjegjës për publikimin |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Informacion rreth këshilltarëve:** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Lista e këshilltarëve.<br>2. Biografi e shkurtër e këshilltarëve.<br>3. Kontakte të këshilltarëve nr. telefonit/ email-i zyrtar. | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja......Strukturat e KB \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 2 | **Informacion rreth komisioneve:** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Përshkrimi dhe përbërja e komisioneve.<br>2. Njoftim për takimet e komisioneve.<br>3. Agjenda dhe dokumentet për diskutim.<br>4. Raportet e mbledhjeve të komisioneve për projekt-aktet e diskutuara. | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja......Komisionet e KB \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 3 | **Kuadri rregullator i këshillit NJVV:** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Ligje dhe udhëzime për qeverisjen vendore me fokus këshillat.<br>2. Rregullore e funksionimit të këshillit të NJVV-së.<br>3. Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të këshilltarëve NJVVe. | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja......Legjislacioni, Kodi & Rregulloret e | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4. Rregullore për marrëdhënien e këshillit NJVV me publikun dhe median.<br>5. Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve, dhe iniciativave qytetare. | Organizimit & Funksionimit të KB \| Bashkia Tepelenë a | | | |
| 4 | **Mbledhjet e këshillit:**<br>Përfshin bërjen publike të:<br>1. Njoftimi paraprak për mbledhjet (data, ora, vendi, agjenda).<br>2. Dokumente përgatitore për mbledhjet.<br>3. Procesverbalet dhe vendimet pas mbledhjeve.<br>4. Mbledhjet live të Këshillit . | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……Njoftimet e KB \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 5 | **Konsultimet publike:** Përfshin bërjen publike të:<br>1. Të dhënat e Sekretarit të Këshillit NJVV (Emër Mbiemër, telefon, adresë emaili).<br>2. Plani vjetor i konsultimeve të Këshillit.<br>3. Regjistri i projekt-akteve për konsultim.<br>4. Njoftimi i konsultimeve në faqen e internetit të Këshillit.<br>5. Përmbledhje e pas-konsultimit në raport zyrtar.<br>6. Raporti vjetor i transparencës së konsultime publike/dëgjesave publike. | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……Konsultimet Publike & Fushatat Informuese \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 6 | **Vendimet e Këshillit të NJVV:**<br>1. Projekt-Vendimet e Këshillit NJVV<br>2. Vendimet e Këshillit të NJVV (relacionet dhe çdo dokument tjetër bashkëlidhur vendimit). | a)Në faqen zyrtare të internetit-menuja……Projekt Vendime, Relacione, Procesverbalet, Vendimet e KB, Regjistri i Mbledhjeve te Keshillit Bashkiak \| | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Bashkia Tepelenë | | | |
| 7 | **Kërkesat dhe përgjigjet drejtuar Këshillit NJVV:**<br>1. Procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe ankesës pranë Këshillit NJVV.<br>2. Formular për dorëzimin e kërkesave Këshillit NJVV.<br>3. Formular për dorëzimin e ankesave Këshillit NJVV.<br>4. Regjistër i kërkesave dhe përgjigjeve i Këshillit NJVV (përfshirë përgjigjen e dhënë, të anonimizuar) | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja...Regjistri Elektronik i Kërkesave, Ankesave, Nismave & Peticioneve \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |
| 8 | **Veprimtaria e Këshillit, Komunikimi me Publikun dhe aspekte të tjera:**<br>1. Raporti vjetor i punës së këshillit.<br>2. Buxheti vjetor i këshillit.<br>3. Raporti vjetor i konsoliduar për zbatimin e buxhetit.<br>4. Kalendari vjetor për trajnimet.<br>5. Vlerësim i performancës së këshilltarëve nga aktorë të brendshëm.<br>6. Vlerësim i performancës së këshilltarëve nga OSHC-të.<br>7. Regjistër i peticioneve dhe iniciativave qytetare.<br>8. Deklaratë publike e Titullarit/es së Këshillit për përmirësimin e transparencës.<br>9. Regjistër i OSHC-ve dhe ekspertëve lokalë.<br>10. Statistika | a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja<br><br>Performanca, Llogaridhënia & Transparenca \| Bashkia Tepelenë | Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre | Këshilli i NJVV | Këshilli i NJVV |